

UNIVERSITETI I EVROPES JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



FAKULTETI I DREJTËSISË  
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ  
FACULTY OF LAW

**STUDIMET PASDIPLOMATIKE – CIKLI I DYTË**

**TEZA:**

**“PSIKOLOGJIA KRIMINALE E VRASËSVE SERIK”**

Kandidate:

Raza Peci

Mentore:

Doc. Dr. Vedije Ratkoceri

*Tetovë, 2021*

## PËRMBAJTJA

Abstrakt.....	7
Abstrackt.....	8
Апстракт.....	9
Hyrja.....	10
Lënda e hulumtimit.....	11
Qëllimi i hulumtimit.....	11
Hipoteza.....	12
Metodologjia e punimit.....	14
Rëndësia e punimit.....	14

## KAPITULLI I PARË

NJOHURI TË PËRGJITHSHME MBI TERMIN VRASËS SERIK.....	15
1. Vështime të përgjithshme mbi historikun e shfaqjës së vrasjeve të shumëfishta.....	15
2. Qfarë nënkutojmë me termin “vrasës serik”.....	19
3. Disa definicione.....	20
4. Femrat si vrasëse serike.....	22
5. Çfarë na thotë Psikologjia, Psikiatia dhe Neuroshkenca.....	25

6. Të lindur apo të krijuar.....	25
7. Elementet përbërëse të një vrasësi serik.....	28
8. Zhvillimet e mangëta dhe gjenet (ADN).....	29

## **KAPITULLI I DYTË**

FAKTORËT KRYESORË QË NDIKOJNË NË PARAQITJEN E KRYERSVE TË VRASJEVE SERIKË DHE DJALLËZORE.....	31
--	----

1. Sëmundjet mendore.....	31
2. Çrregullimet e vëmendjes.....	32
3. Hipërseksualiteti.....	34
4. Çrregullime të personalitetit .....	34
5. Psikopati.....	36
6. Personalitet sadist.....	37
7. Neglizhenca prindërore, poshtërimi prindërorë, joshja prindërore.....	40

### **8 . FAKTORËT E TJERË QË MUND TË KRIJOJNË NJË VRASËS SERIK .....44**

9. Adoptimi .....	44
10. Dëmtimi i kokës .....	47
11. Parafilitë.....	47
12.Treshja .....	49
13. Abuzimi më substanca.....	51

## **KAPITULLI I TRETË**

PSE DUHET TË MERREMI ME KËTA NJERËZ .....	53
1. Roli prindëror në parandalimin e kësaj dukurie – Masat e parakohshme .....	54
2. Roli i qendrave korrektuese.....	55
3. Dënimet adekuatë për kryerësit.....	56

## **KAPITULLI I KATËRT**

VRASËSIT SERIK – ASPEKTI KRAHASIMOR.....	59
1. Vrasësit serik në SHBA.....	59
2. Vrasësit serik në disa vende të Evropës.....	63
3.Vrasësit serik në Maqedoninë e Veriut .....	67
PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME.....	69
LITERATURA E SHFRYTËZUAR .....	71

## **DEKLARATA E ORIGJINALITETIT**

*Deklarojë se ky punim është shkruar nga unë, nuk është prezantuar asnjëherë para ndonjë institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar më parë. Të gjitha referencat dhe citimet në tekst janë bërë në bazë të burimeve të paraqitura në fusnota.*

---

*Me Respekt,*

*Raza Peci*

## *FALËNDERIM*

*Për rrugëtimin tim drejt shkollimit pasdiplomatik dhe për arritjen e qëllimeve të mija, kam gëzuar mbështetje nga njerëz të cilët do të doja t'i falënderoja nga zemra.*

*Fillimisht do doja të falënderoja udhëheqësen e punimit tim, Prof. Dr. Vedije Ratkocerin për gatishmërinë e shprehur që të bashkëpunoj me mua, për motivin, durimin, këshillat dhe vërejtjet e saj të dobishme që kontribuan jashtëzakonisht për të bërë të mundur këtë punim.*

*Në mënyrë të veçantë falënderoj familjen time që gjithmonë kanë qenë pranë meje në këtë rrugëtim duke më dhënë mbështetje, dashuri dhe motivim gjatë gjithë kohës.*

*Faleminderit!*

## ABSTRAKT

Forma më e rrallë e vrasjeve është vrasja e serike. Si formë e rrallë e krimit, është mjaftë interesante dhe tërheqëse për ta përcjelle.

Termi “Vrasës Serik” mund të themi se është bërë frazë mjaftë tërheqëse për njerëzimin.

Kjo magjepsje me vrasësit serik, bazohet në nevojën për të kuptuar pse dikush është në gjendje të bëjë gjëra kaq të tmerrshme dhe djallëzore ndaj njerëzve që në shumicën e rasteve nuk kanë pasur asnjë ndikim në jetën e tyre, ndaj njerëzve të rastësishëm e krejtësisht të huaj për vrasësin.

Në këtë punim do të analizohet psikologjia e vrasësve serik. Kryesisht do të hulumtohet se çfarë na thotë psikologjia, psikiatria dhe neuroshkenca për mendjet e atyre, veprimet e të cilëve mund të përshkruhen si veprime të liga dhe djallëzore.

Do të përshkruhen tiparet e personalitet dhe sjelljet që rezultojnë në sjellje kriminale, faktorët që ndikojnë në paraqitjen e kryerësve të vrasjeve serike.

Duke shqyrtuar rrënjën psikologjike, sjelljet e tyre në jetën realë, diskutohet dhe mendohet se si veprimet e tyre mund të shpjegohen në terma shkencorë, si këta njerëz pa ndjeshmëri por shumë të orientuar drejtë qëllimit të tyre mendojnë dhe veprojnë ashtu si veprojnë.

*Fjalët kyqe: Vrasës serik, psikopat, djallëzor, sjellje kriminale, vrasje*

## ABSTRACT

The rarest form of homicide is serial homicide also known as “serial homicide” which is a rare form of crime. “Serial killer” is the most used definition to describe a person who kills or commits multiple murders.

The necessity to understand as why someone is able to do this kind of crime, gives you a kind of fascination with serial killers, who are able to have or lead a normal life after doing horrible and devilish things.

This fascination with serial killers is based on the need to understand why someone is able to do such terrible and devilish things to people who in most cases have had no impact on their lives, to random and completely foreign people to the killer.

In this writing, we will analyze the psychology of serial killers, and research what psychiatry and neuroscience say about their mind. What makes them commit these evil and devilish actions? How do we describe their traits and behaviors that result in criminal behavior? What factors influence the appearance of serial killing?

By examining the psychology root, this behavior, can be explained in scientific terms and how these people are intensive on the way they act.

*Keywords: Serial killer, psychopath, devilish, criminal behavior, murder.*

]



## Апстракт

Најретка форма на убиство е сериското убиство. Како редок облик на криминал, тој е доста интересен и претпочитан за истражување.

Терминот „сериски убиец“ може да се каже дека стана доста интересен за човештвото.

Оваа фасцинација со сериски убијци е неопходна за да се разбере зошто некој е во состојба да го стори ова автоматски толку ужасно и ѓаволско нешто што во случај да не може да има влијание врз нивниот животен век, соодветно и потполно туѓ за убиецот.

Во овој труд ќе ја анализираме психологијата на сериските убијци. Главно ќе се истражува пристапот на науките на психологијата, психијатријата и невронауката за нивниот ум, нивните постапки, кои може да се опишат како зловни и ѓаволски постапки.

Истотака сме истражувале персонализирани одлики и однесувања кои резултираат во криминално однесување, особено факторитед кои влијаат на појавата на сторителите на сериски убиства.

Испитувајќи го психолошкиот корен, нивното однесување во реалниот живот, се дискутира и се размислува како работи нивниот ум во научна смисла, зошто овие луѓе се нечувствителни на многу повеќе насоки, и зошто постапуваат како што постапуваат во случаите на сериски убиства.

*Клучни зборови: Сериски убиец, психопат,, криминално однесување, убиство.*

## **HYRJE**

Objekt studimi i kësaj teme të magistraturës janë kryerësit e vrasjeve të shumëfishta. Do të studiohet mendja, motivi, tiparet dhe në veçanti faktorët që ndikojnë në krijimin e një vrasësi të kësaj kategorie.

Vrasja është vepër e kundërligjshme me qëllim të privimit nga jeta me dashje, vepër për të cilën, kushdo që e bënë me qëllim do të përgjigjet penalisht për të.

Punimi përbëhet nga përmbajtja, katër kapituj, përfundimit dhe bibliografisë së shfrytëzuar, libra dhe burime të tjera.

Në kapitullin e parë do të shqyrtohen njohuritë e përgjithshme mbi termin vrasës serik, do të ketë vështrime të përgjithshme mbi historikun e shfaqjes së vrasjeve të përsëritura, çfarë nënkuptojmë me termin Vrasës serik në përgjithësi, disa definicione dhe do të flitet për femra si vrasëse serike, Çfarë na thotë psikologjia, psikiatria dhe neuroshkenca. A lindin personat e tillë apo krijohen, cilat janë elementet përbërëse të një vrasësi serik, a janë mangët të zhvilluar apo ka të bëjë me ADN-në e tyre.

Në kapitullin e dytë do të shqyrtohen faktorët kryesorë dhe faktorë të tjerë që ndikojnë në paraqitjen e kryerësve të vrasjeve serike.

Në kapitullin e tretë do të trajtohet se cila është arsyeja pse duhet të merremi me këta njerëz, cili është roli prindëror në parandalimin e kësaj dukurie, cilat janë masat a parakohshme, cili është roli i qendrave korrektuese dhe çfarë dënimesh mund të u shqiptohen kryerësve.

Në kapitullin e katërt do të flitet për vrasjet serike, në aspektin krahasimor. Do të krahasohen rastet e vrasjeve serike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës me disa vende të Evropës dhe vrasësit serik në vendet e rajonit (Maqedoninë e Veriut, Kosovë dhe Shqipëri).

## **Lënda e hulumtimit**

Lëndë shqyrtimi dhe hulumtimi në punimin tim të masterit do të jetë psikologjia e kryerësve të vrasjeve serike. Kryesisht do të hulumtohet se çfarë na thotë psikologjia, psikiatria dhe neuroshkenca për mendjet e atyre veprimet e të cilëve mund të përshkruhen si veprime të liga. Do të përshkruhen tiparet e personalitet dhe sjelljet që rezultojnë në sjellje kriminale, faktorët që ndikojnë në paraqitjen e kryerësve të vrasjeve serike, sa ndikojnë këto shkaqe në sistemin e drejtësisë, cilat janë dënimet më të shpeshta që u shqiptohen kryerësve të veprave të tilla si dhe do të studiohen rastet konkrete në disa vende.

Tema e cila është objekt hulumtimi do të trajtohet duke u bazuar në koncepte teorike dhe praktike të faktorëve kriminogjen që ndikojnë në shfaqjen e kësaj dukurie kriminale, të zbatimit të dispozitave ligjore nga aspekti i fushës penale, administrative, si dhe i masave për parandalimin e kësaj dukurie.

## **Qëllimet e hulumtimit**

Sa herë kemi parë një vrasje në një shfaqje televizive dhe i kemi thënë vetes, “Si mundet dikush të bëjë një gjë të tillë?”

Sot neuroshkenctarët mundohen të hartëzojnë burimin e të keqes që mund të imagjinohet në trurin e njerëzve të pandërgjegjshëm e që në shoqëri njihen si: psikopatë.

Duke shqyrtuar sjelljet e tyre në jetën reale, diskutohet dhe mendohet se si veprimet e tyre jonjerëzore mund të shpjegohen në terma shkencorë, si këta njerëz pa ndjeshmëri por shumë të orientuar drejtë qëllimit të tyre mendojnë dhe veprojnë ashtu si veprojnë.

Ndër qëllimet dhe arsyet që kam vendosur ta trajtojë këtë temë janë:

- Temë e padiskutueshme në vendet e rajonit dhe rrallë here e dëgjuar në mediat tona
- Si mund ta dallojmë një person të tillë në shoqëri
- A kemi raste të vrasjeve serike në vendet e rajonit
- Nevoja e studimit të kësaj dukurie kriminale, masat që mund të ndërmerren në parandalimin e kësaj dukurie

Duke u bazuar në të gjitha arsyet e lartcekura rezulton që qëllimi i hulumtimit tim është njohja, trajtimi dhe analizimi i psikologjisë kriminale të vrasësve që rezultojnë së janë të pranishëm në mesin tonë, shtrirjen e kësaj dukurie dhe në bazë të studimeve psikologjike, neurologjike të mësojmë si të luftohet dhe të parandalohet kjo dukuri

## **Hipotezat**

Me qëllimin të studimit dhe hulumtimit të dukurisë kriminale, vrasje të shumëfishta kam ngritur këto hipoteza:

### **Hipoteza e parë:**

Për kundër asaj se në shtetin tonë dhe më gjerë ekzistojnë infrastruktura ligjore më të cilat sanksionohen veprat penale si vrasje të shumëfishta, zbatimi i tyre mbetet i mangët për arsye së psikologjia kriminale është çështje e ndërlikuar dhe është vështirë që kryerësit të marrin dënime që shqiptohen në kushte normale.

### **Hipoteza e dytë:**

Shkalla e vetëdijesimit të shoqërisë e sidomos prindërve të cilët keqtrajtojnë fëmijët e tyre në mënyra të ndryshme duke mos i menduar pasojat që mund ti ketë aj fëmijë nga tortura psikike dhe fizike që u shkaktohet nga ta.

## **Hipoteza e tretë:**

Njohja e mangët ose fare e shoqërisë e sidomos prindërve për shenjat kriminale të një personi, duke filluar nga fëmijëria (keqtrajtimi i kafshëve apo vënja e zjarreve), ku në çdo rast, tortura e kafshëve është shkaktarë shumë i rëndësishëm për dhunën e mundshme në të ardhmen, sepse një fëmijë që i vë zjarre një mace apo ndonjë gjallese tjetër, do të thotë që ai fëmijë nuk ka dhembshuri për krijesat e gjalla, nuk i nënshtrohet dhimbjes së tyre dhe me të gjitha gjasat në vetën e tij ai është duke u hakmarrë për keqtrajtimet nga prindërit e tij ose vetëm nga njëri prind.

Duke u nisur nga hipotezat e ngritura më lartë dhe më qëllim të arritjes së rezultateve të dëshirueshme të hulumtimit tim, gjatë trajtimit të kësaj temë do të shqyrtohen këto pyetje kërkimore:

- Si definohet një vrasës serial ?
- Cilat janë shenjat kryesore të vrasësve serial ?
- A lindin të tillë, apo krijohen nga rrethi familjar ose shoqëria ?
- Cilat janë problemet mendore të personave të tillë ?
- Cilët janë faktorët kryesorë që ndikojnë në shfaqjen e kësaj dukurie?
- Cilat janë motivet kryesore, që shtynë deri te vrasjet mizore?
- Pse jemi të fascinuar nga kjo dukuri e rrallë ?
- Çfarë e karakterizon?
- Sa janë të zbatueshme dënimet për persona me probleme mendore?
- Cilat janë masat që mund të ndërmerren për parandalimin e kësaj dukurie?
- A do ta kuptojmë edhe vetën tonë më mirë mbas këtij studimi ?

## **Metodologjia e hulumtimit**

Në këtë hulumtim do të aplikoj metodat bashkëkohore karakteristike për shkencat shoqërore.

Metoda ime e hulumtimit të këtij punimi do të përfshijë metoda relevante kërkimore hulumtuese. Do të shfrytëzojë literaturë adekuate studimore si: libra, punime, revista, dokumentarë të bazuar në ngjarje të vërteta, do të hulumtojë edhe nga ueb faqet e ndryshme të internetit.

Ndër metodat që do të aplikohen në këtë hulumtim janë:

- Metoda historike,
- Metoda e analizës juridikë,
- Metoda komparative,
- Metoda statistikore,
- Metoda e vrojtimit direkt dhe indirekt,
- Metoda e studimit të rasteve individuale etj.

Përmes aplikimit të këtyre metodave do të mundohem që ta njoh, trajtoj dhe analizoj dukurin e vrasjeve serike si dhe të propozoj disa masa më qëllim të parandalimit dhe luftimit të kësaj dukurie e cila është e pranishme në çdo shoqëri e që në shoqërinë tonë trajtohet dhe diskutohet shumë pak ose fare.

## **Rëndësia e punimit**

Studimi i psikologjisë kriminale aq sa është mërzitese në të njëjtën kohë mund të themi se është edhe magjepsëse. Ne lexojmë në lidhje me psikopatë kriminal libra, shikojmë filma të portretizuar nga ta , dëgjojmë për mënyrat e vrasjeve se si i bëjnë. Ata janë njerëz që bëjnë gjëra të tmerrshme si : vrasje, grabitje, tortura, dhunime e gjithë këtë e bëjnë pa asnjë shenjë dhembshurie për viktimat. Ne sigurisht që pyesim vetën: si mund të jenë këta njerëz kaq të ligë dhe shpresojmë që të mos të takojmë persona të tillë, por a mund ta njohim një psikopat, a mund ta dallojmë një të tillë nëse e hasim diku në rrugë apo në punë. Shkencëtarët thonë se shanset janë në fakt mjaft të mira që shumë nga ne kemi takuar persona të tillë pa kuptuar kush ose çfarë janë ata.

Aq sa do të studiohet psiqika kriminale e kryerësve të vrasjeve, eksplorimi do të jetë i tillë që do të na çon jo vetëm në një kuptim më të mirë të psikopatit kriminal, por në fund do ta kuptojmë më mirë edhe vetveten.

## KAPITULLI I PARË

### NJOHURI TË PËRGJITHSHME MBI TERMIN VRASËS SERIK

#### 1. *Vështrime të përgjithshme mbi historikun e shfaqjes së vrasjeve të shumëfishta*

Të shkruash për vrasje serike të kryera nga një person i vetëm, aq sa është e vështirë, mund të themi se në te njëjtën kohë është dhe shumë fascinante. Të kuptosh se si një person për arsye aspak të arsyeshme, është në gjendje të vras tjetrin është ende një mister dhe diçka që tejkalon çdo kufi të mendimit të shëndoshë. Duke u nisur nga kjo se njerëzit me mendime të shëndosha, pa tendenca dhe mendimin për të shuar një jetë për motive të ulta, nuk e kemi të qartësuar një veprim të tillë, mundohemi që këtë të keqe ta kuptojmë, duhet studiuar se si lind e keqja te një person, si është e mundur që një person të kaloj në një ligësi të tillë. Si këta njerëz pa asnjë ndjeshmëri por shumë të orientuar drejtë qëllimit të tyre mendojnë dhe veprojnë ashtu si veprojnë.

Që të kuptojmë, pse ekziston e keqja në disa persona, duhet të kuptojmë se nga vjen ajo. A është kjo e keqe diçka që vjen nga brendësia jonë.

Çka ne quajmë psikopatë, sëmundje personale dhe ato që ne i quajmë çrregullime psikopatike, personaliteti apo mungesë e ndjeshmërisë, kontrolli i impulsit, planifikimi i dobët.

Psikopatët janë në ekstreme të sjelljes njerëzore. Por të gjithë përballlemi me zgjedhjen për të bërë mirë dhe për të bërë keq, dhe për mijëra vjet kemi luftuar për t'i kuptuar këto zgjedhje.

Me studimin e të keqes, historikisht janë marrë njerëzimi. Siç paraqitet edhe në dokumentarin e Morgan Freeman "The Story of God": *"Kemi gjurmë se qysh në Egjiptin e vjetër 3.500 vite më parë, kjo gjë i ka preokupuar njerëzit të asaj kohe. Me përshkrime në mure, ata kanë shprehur dhe gjykuar personat, veprat e mira dhe të këqijat që i kanë bërë në jetë. Në një mur i njohur si "Tomb of Menna". Menna që ishte një shkruer për Zotin Amun dhe si Menna do të kalojë në jetën e përtejme.*


*Është një skenë në të cilën Menna do të gjykohej për të mirat dhe të këqijat që i ka bërë në jetë.*



*Shpjegohet procesi i funeralit, ku kofini i tij dërgohet para “Zotit Osiris” ( Zoti i Nëntokës ). Në peshore në një rën anë zemra, ndërsa në anën tjetër djallëzorja, në bazë të cilës do të vendoset se a ishte i mirë apo djallëzorë. Në raste se, ka gënjyer, mashtruar apo vrarë, në jetë, këto vepra do ta rëndonin zemrën e tij.*

*Shekuj më pas, kur ideja se në botën tjetër shpërblehen vetëm ata që kanë kryer vepra të mira, u përhap në gjithë shoqërinë Egjiptiane dhe prej atëherë, mund të themi se ka hyrë edhe në librat që konsiderohen të shenjta, në religjione si Judaizëm, Krishterim dhe në Islam”.*

Kriminologet historian besojnë se gjatë gjithë historisë ka pasur vrasës serial. <sup>1</sup> Besohet se legjendat si ujqërit dhe vampirët janë të frymëzuar pikërisht nga vrasësit serik mesjetarë.



Njeriu që mban titullin e Vrasësit serik më të famshëm i të gjitha kohërave është Jack the Ripper, një vrasës i paidentifikuar i cili vraste prostituta, por nuk dihet sakte numri i viktimave të tij. Edhe pse historia e njeh Jack the Ripper si vrasësin e parë serik, ai hynë në grupin e vrasësit

---

<sup>1</sup> S. Waller (2011) "Serial Killers-Philosophy for everyone: Being and killing

serial modern, që do të thotë se nuk është i pari vetëm se në histori nuk njihen emra dhe veprime të vrasësve tjerë serik të shekujve të mëparshëm.<sup>2</sup>

Pasi që nuk njihen shumë emra dhe vepra serike nga e kaluara, ajo çfarë quajmë ne sot vrasje serike ndërlidhet me familjet mbretërore, të cilëve i përket ky titull më shumë. Të njohur nga familjet mbretërore, përgjegjës për vrasjen e mijëra njerëzve janë Vlad i Impaler, Giles de Rais, ndër personat më të pasur në Evropë, sulmoj seksualisht dhe vrau fëmijë fshatarë, kryesisht djemtë, të cilët i kishte rrëmbyer nga fshatrat përreth dhe i kishte marrë në kështjellën e tij.<sup>3</sup> Mendohet se numri i viktimave të tij janë midis 140 dhe 800.<sup>4</sup>



Kontesha famëkeqe Elizabeth Bathory, e lindur në një familje të pasur Hungareze, e cila dyshohet se ka torturuar dhe vrarë diku rreth 650 vajza të reja para se të arrestohej në 1610.<sup>5</sup>

---

<sup>2</sup> Po aty

<sup>3</sup> P. Vronsky (2004) "Serial Killers: The Method and Madness of Monsters."

<sup>4</sup> Po aty.

<sup>5</sup> P. Vronsky. (2007). "Female Serial: How and why Women become Monsters"



H. H. Holmes ishte një nga vrasësit e parë serial të dokumentuar modern në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përgjegjës për vdekjen e të paktën nëntë viktimave në fillim të viteve 1890. Në të njëjtën kohë në Francë, Joseph Vacher u bë i njohur si “ Ripper Francez” pasi vrau dhe gjymtoi 11 gra dhe fëmijë. Ai u ekzekutua në 1898 pasi rrëfeu për krimet e tij.<sup>6</sup>

Shumica e vrasësve serik që janë dokumentuar nga shekulli i 20të dhe 21të, janë nga Shtetet e Bashkuara, prandaj në këtë punim edhe fokusi do të jetë më shumë te vrasësit serik Amerikan.

## **2. Çfarë nënkuptojmë me termin vrasës serik?**

Para se t’i përmendim shkaqet dhe arsyet pse këta persona kryejnë vrasje të shumëfishta duhet të qartësojmë se çfarë nënkuptojmë me termin, “vrasës serial”.

“Vrasja seriale është mbase krimi më hutues pasi është e vështirë të kuptohet se individ të caktuar do të kënaqeshin duke vrarë të tjerët. Ky lloj krimineli dhe sjellja anormale është

---

<sup>6</sup> Ramsland. K (2009) “The Werewolf Syndrome: Compulsive Bestial Slaughterers. Vacher the Ripper”

shqetësuese sepse thekson një të vogël por të mundimshme grup njerëzish në shoqëri që merren me akte të çmendurisë dhe terrorizmit por të cilët nuk janë të çmendur”<sup>7</sup>. Viktimat zakonisht janë të huaj, të papërgatitur, njerëz që kanë qenë në kohë dhe vendin e gabuar. Por, çfarë kuptojmë me vrasës serik?!

Termin vrasës serial e kemi dëgjuar shpesh në filma, libra, dhe media por, i pari që e ka përdorë këtë term ishte hetuesi i FBI-së: “Robert Ressler”, në vitin 1974 në akademinë e policisë në Bramshill, Hampshire, Angli. Ressler mendoi se duke kuptuar se si punonin ata kriminelë dhe pse, mbase herën tjetër policia mund t’i gjejë më lehtë, ata që i kërkonte.<sup>8</sup>

### 3. Disa definicione

Ekzistojnë tre lloje kryesore. Vrasjet serike të pacientëve nga infermierë dhe mjekë (të cilët përbëjnë një nga variantet më pak të zakonshme). Një llojë i dytë i vrasjeve serike ka të bëjë me vrasjet me intervale të gjatë të personave të huaj dhe të rastit, pavarësisht nga mosha ose gjinia. Këta vrasës janë burra mizantropë që thjesht urrejnë njerëzit (përsëri nuk ka ndonjë motiv seksual). Ky është gjithashtu lloji më i rrallë. Më në fund, ekziston grupi më i madh (megjithëse ende i pazakontë): burrat që kryejnë seri vrasje serike me motive seksuale. Kur njerëzit flasin për vrasësit serial, ky është lloji që ata zakonisht nënkuptojnë, pra vrasës serik me motive seksuale. Elementi seksual është thelbësor për llojin, pasi skenari është ai i përdhunimit dhe i ndjekur me vrasje (më e zakonshme) ose ndryshe vrasja e ndjekur nga seksi me kufoma (ky lloj pasioni është më pak i zakonshëm). Po ashtu homicidi serik i kryer nga gratë të cilat kërkojnë hakmarrje për gabime seksuale që u janë bërë (incesti zakonisht).

Në kohë lufte ose konflikti në grup, ku nuk mungojnë torturat dhe vrasjet që kryhen nga funksionarë të shtetit: (burra dhe disa gra) të cilën dhe nuk do të njiheshin nga miqtë dhe

---

<sup>7</sup> Knight, Z. (2006, 24 dhjetor). *“Some thoughts on the Psychological roots of the behavior of Serial Killers as Narcissists: An Object relations prespective”*

<sup>8</sup> Sullivan, B. (2013, 29 dhjetor). *“The FBI Investigator who Coined the term “Serial Killer”*  
<https://www.npr.org/2013/12/29/258160192/the-fbi-investigator-who-coined-the-term-serial-killer>

fqinjët e tyre si sadistë ose ndryshe njerëz jonormal sepse ata thjesht po bëjnë një punë të keqe, pra po kryejnë vrasje të shumta (serike) por nisur nga ajo që ata besojnë nga udhëheqësi ose ndonjë person tjetër i lartë që thjeshtë është një punë që “duhet të bëhet”.<sup>9</sup> Pas përfundimit të konfliktit, shumica e personave të tillë kthehen në jetën e tyre të zakonshme dhe familjet e tyre të zakonshme, duke vazhduar të mbështesin punën e tyre të zakonshme. Në asnjë mënyrë këta persona nuk mund të vendosen jashtë sferës së keqës, por vrasja serike e tyre është një llojë tjetër i së keqës që dallon nga ajo e vrasësve serik “të njohur”.

Sipas FBI preferohet ta kufizojnë frazën vrasës serik tek personat që kanë vlarë të paktën tre persona, edhe pse sugjerohet se bëhet fjalë për një vrasës serik edhe vetëm pas dy vrasjeve ( për shkak të ngjashmërive në metodën dhe zgjedhjen e viktimës). Arsyeja për këtë përkufizim është zbutja e ankthit në publik. Nëse mediat do të raportonin nga çdo rast i dy vrasjeve të tilla brenda një hapsire të shkurtër, në të njëjtën zonë, publiku do të territorizohej dhe do të kishte ndikim edhe në punën e përpiktë detektive të nevojshme për t’a kapur vrasësin.

## 2.1 Femrat si vrasëse serike

Femrat në botën e krimit nuk janë dhe aq prezentë. Shumica e krimeve që ndodhin nëpër botë, janë zakonisht të gjinisë mashkullore. Aq sa janë të rralla në krime të përgjithshme edhe më të rralla janë në krimin e vrasjeve serike. Sipas The Journal of Fernsic Psychiatry & Psychology, ka prova që 16% e të gjithë vrasësve serialë janë gra.<sup>10</sup>

Në përgjithësi, burrat kanë rreth 6 deri në 7 herë gjasa të vrasin të tjerët se sa gratë (d[ Obran, 1990; Kellermann dhe Mercy, 1992)<sup>11</sup>, por ky raport është i ndryshueshëm për vrasje në një mjedis shtëpiak (Trube Becker, 1982) zbuloj se në 23% të rasteve bashkëshortore, autori ishte një grua. ( Gra të cilat kanë vuajtur një kohë të gjatë nga abuzimi i partnerit),(Meraj dhe

---

<sup>9</sup> Stone H. “The Anatomy of Evil”, New York (2017)

<sup>10</sup> M. Newton. (2006) “The Encyclopedia of Serial Killers”

<sup>11</sup> Kellermann AL, Mercy JA (1992), Men, women and murder: gender-specific differences in rate of fatal violence and victimisation. Journal of Trauma 33.

Satzmann,1989; Trube Becker,1982)-.<sup>12</sup> Ky lloj i krimit nuk hynë në vrasjet qe janë duke u trajtuar në këtë temë. Ky lloj krimi, ndodh nga gratë që janë kryesisht të pambrojtura dhe aktin e vrasjes e kryejnë, pas abuzimit shumëvjeçare, e në moment te caktuar shtyhen të ndërmarrin një veprim të tillë, pra të vrasin bashkëshortin apo partnerin e tyre.

Sido që të jetë, kemi raste kur edhe femrat kryejnë vrasje të shumëfishta, por motivi dhe mënyra dallon nga vrasjet serike që kryhen nga gjinia mashkullore.

Përpjekjet për të karakterizuar fenomenin e vrasjeve serike te femrat sipas metodave dhe mënyrave më të zakonshme janë bërë nga shumë autorë. Motivi më i zakonshëm i identifikuar ishte përfitimi material ose kënaqësi e jashtme e ngjashme ndërsa sadist “hedoist” ose vrasje me motive seksuale duket të jetë jashtëzakonisht e rrallë tek femrat <sup>13</sup>. Vrasjet me motive seksuale apo pa ndonjë interes janë motive jashtëzakonisht të rralla te femrat, për dallim nga meshkujt. Megjithatë edhe pse sipas autorëve motivi kryesor pse femrat kryejnë vrasje të shumëfishta është motivi pasuror, prap se prap mbetet një teori jo e qëndrueshme sepse, nuk mund ta përshkruaj një vrasëse serike tipike, duke marr parasysh se në historinë e krimit serik te femra ka motive edhe jo aq të arsyeshme.

Hickey në veprën e tij “Serial killers and their victims” (1991 me rezultate të azhurnuara në 2010), zhvilloi një nga studimet më të mira gjithëpërfshirëse të femrave vrasëse serike deri më sot. Ai shqyrtoi historitë dhe krimet e 64 vrasësve serike të cilat kryen vrasjet e tyre në Shtetet e Bashkuara. Ai studio rastin, raportet dhe intervistat e zhvilluara me to. Ai zbuloi se 98% e femrave vrasëse serike ishin të bardha, rreth moshës 31 vjeç kur filluan krimet e tyre dhe vranë në periudhë prej 7 vjet dhe secila kishte vranë së paku 10 viktime (statistika të sakta nuk janë raportuar në librin e tij).

Mënyra më e shpeshte e vrasjeve ishte helmimi, ndërsa motivi kryesor ishte fitimi financiar. Metodrat që femrat vrasëse serike përdorin për vrasje janë të fshehta ose me profil të ulët, siç është vrasja me helm (zgjedhja e preferuar për vrasjen). Metoda të tjera të përdorura përfshijnë të shtëna (të përdorura nja 20%), mbytjen (16%), goditje me thikë (11%) dhe

---

<sup>12</sup> Trube-Becker E. (1982) Dir Frau als Täter und Opfer von Gewaltdelikten aus rechtsmedizinischer Sicht. In: Nass G Gerechtigkeit für Frauen. Beiträge zur soziologischen, psychologischen, psychologischen und kriminologischen Problematik.

<sup>13</sup> Frei. A, Völlm. B, Graf. M & Dittmann. V “Female serial killer: review and case report” (2006, 13 Korrik)  
<file:///C:/Users/HP/Desktop/re/Female%20serial%20killing-%20review%20and%20case%20report.pdf>

mbytjen në ujë (5%). Vrasjet i kryejnë në vende të veçanta, si në shtëpitë e tyre, në institucione shëndetësore, ose në vende të tjera, por gjithmonë brenda qytetit dhe shtetit ku jetojnë.

Sipas Hickey-it, këto janë metodat dhe mënyrat e vrasjeve që kryhen nga femrat si vrasëse serike:

Metodat	Motivet
1. Helmimi (80%)	1. Parat (74%)
2. Vrasje me të shtëna (20%)	2. Kontrolli (13%)
3. Goditje me shkop të rëndë (16%)	3. Kënaqësia (11%)
4. Zënie fryme (16%)	4. Seksi (10%)
5. Goditje me thikë (11%)	5. Droga, përfshirja në ndonjë kult, mbulesa ose ndjenja e pamjaftueshmërisë (24%)
6. Mbytje në ujë (5%)	

Hulumtimi në ndryshimet midis gjinive në vrasjen serike ka zbuluar se vrasësit meshkuj kanë gati gjashtë herë më shumë gjasa të vrasin një të huaj, ndërsa vrasësit serialë femra kanë gati dy herë më shumë gjasa të vrasin një person që ata tashmë e kanë njohur.<sup>14</sup>

Për më tepër, rreth 65.4% e vrasësve serialë meshkuj – në një shkallë apo në një tjetër ndiqnin viktimat e tyre para se t’i vrisnin, krahasuar me vetëm 3.6% të grave vrasëse serike.<sup>15</sup>

Hickey në vitin 2002 studioj 199 vrasës serik meshkuj dhe bëri dallimin e madh mes motiveve dhe metodave të femrave si vrasëse të shumëfishta dhe meshkujve:

<sup>14</sup> The differences between male and female serial killers.  
<https://www.crimeandinvestigation.co.uk/shows/making-a-monster/articles/the-differences-between-male-and-female-serial-killers#:~:text=Male%20killers%20are%20nearly%20six,they're%20already%20familiar%20with.>

<sup>15</sup> Po aty

Metoda	Motivi
1. Armë zjarri (41%)	1. Seksual (55%)
2. Mbytje (duke zënë frymën) (37%)	2. Kontrollues (29%)
3. Goditje me thikë (34%)	3. Financiar, para (19%)
4. Goditje me shkop të rëndë (26%)	4. Kënaqësi (16%)
5. Vetëm me armë zjarri (19%)	5. Racizëm dhe urrejtje (11%)
6. Helmim (11%)	6. Probleme mendore (6%)
7. Mbytje në ujë (3%)	7. Frymëzuar nga ndonjë kult (5%)
8. Metoda tjera (2%)	8. Vëmendje (2%)

Pra siç shihet nga tabelat krahasuese, kontrasti më i madh i vrasësve serik mashkullor dhe vrasësve serike femërore qëndron në motivin dhe metodën e kryerjes së krimin.

Vrasësit serik mashkullor zakonisht vrasin për motive seksuale, ndërsa tek femrat motivi seksual zë vendin e katërt, duke mos etiketuar femrën fare si vrasëse serike seksuale. Femrat zakonisht vrasin për motive financiare në shumicë, duke vlarë bashkëshortë, apo partnerin e tyre mashkullor, në mënyrë që të përfitojnë nga ndonjë testament apo para të sigurimeve, gjë që u jep më shumë “arsye” mendjes kriminale se sa motivet mashkullore që si kënaqësitë seksuale të momentin, kontrolli, çrregullimet e personalitetit që për dallim nga vrasëset femra nuk mund të “arsyetohen” fare.<sup>16</sup>

Por çfarë qëndron mbrapa këtij dallimi kaq të madh në mes të gjinive?

Kemi një teori shumë interesante, sipas të cilës evolucioni i këtij fenomeni qëndron shumë kohë më parë.

Penn State Harrisburg Marissa Harrison ka kryer një hulumtim të gjerë në këtë drejtim dhe beson se rolet specifike gjinore gjatë historisë mund të shpjegojnë sjelljen e tanishme mes

<sup>16</sup> The differences between male and female serial killers.

<https://www.crimeandinvestigation.co.uk/shows/making-a-monster/articles/the-differences-between-male-and-female-serial-killers#:~:text=Male%20killers%20are%20nearly%20six,they're%20already%20familiar%20with.>



gjinive. Në thelb, ideja është që rolet e ndara gjinore janë ngulitur në trurin tonë.

Qasja e ndryshme mund të jetë deri në diçka aq themelore sa nocionet e burrave që tradicionalisht janë “gjahtarë” dhe gratë “mbledhëse”.<sup>17</sup>

*“Historikisht, burrat gjuanin kafshë si pre dhe gratë mblidhnin burime përreth, si drithëra dhe bimë, për ushqime”* thotë Harrison në letrën e saj lidhur mbi këtë temë.”

Si te çdo vrasës, qoftë vrasës që ka kryer vetëm një vrasje apo vrasje recidiviste, për të kuptuar dhe “arsyetuar” vrasjen, shikohet historia personale, nga fëmijëria e deri te momenti që e ka nxit personin të kryej një akt të tillë. A ka pasur fëmijëri abuzive, a është keqtrajtuar nga prindërit, a ka qenë fëmijë i abuzuar, a ishte, apo është përdorues i lëndëve narkotike, a ka shfaqur shenja psikopatie qysh nga mosha fëmijërore.

## **2. ÇFARË NA THOTË PSIKIATRIA, PSIKOLOGJIA DHE NEUROSHKENCA**

### **2.1 Të lindur apo të krijuar**

Argumentet më të shpeshta në shkencë lidhur me teorinë se vrasësit serik lindin me tipare kriminale dhe argumenti tjetër që vrasësit serik krijohen me kalimin e kohës nga faktorët e jashtëm kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të shumta. Me të lindur duke studiuar trurin (gjetjen paraprake kriminale) të një vrasësi recidivist dhe teoria tjetër me faktorët e jashtëm duke mësuar më shumë rreth jetës së tyre, se si janë rritur dhe duke analizuar eksperiencat që kanë ndikuar në çorientimin e tyre dhe në sjellje kriminale.

Teoria se kriminelet lindin me disa veti anatomike-biologjike që i bëjnë të dallojnë nga pamja e jashtme ekziston qysh nga koha mesjetare. Njerëzit me shekuj kishin mendime të gabuara, duke propozuar shkaqe të ndryshme biologjike, duke përmendur deformimin e kokës, veshët e

---

<sup>17</sup> The differences between male and female serial killers.

<https://www.crimeandinvestigation.co.uk/shows/making-a-monster/articles/the-differences-between-male-and-female-serial-killers#:~:text=Male%20killers%20are%20nearly%20six,they're%20already%20familiar%20with.>

mëdhenj apo të vegjël, nofulla të qitura jashtë, koka të gjata, persona me tatuazhe etj, si “shenja” dhe “prova” që ata janë apo mund të jenë të prirur për kryerje të vrasjeve. Sipas tyre këto tipare ishin ato çfarë e dallonin një kriminel nga njerëzit normal, apo siç i quante Qesaro Lombroso (doktor i drejtësisë dhe doktor i mjekësisë) shenja të degjenerimit.

Qesaro Lombroso kriminelët i ndan në pesë grupe: në kriminelë të lindur, kriminel të sëmurë në pikëpamje shpirtërore, kriminel nga pasionet, kriminel të shprehive dhe kriminel të rastit.<sup>18</sup>

Për më shumë se një shekull, njerëzit ishin të këtij mendimi, duke u bazuar me “provat” që ishin të njohura deri atëherë, gjë që sot na bënë të tundim kokën.

Nga arritjet e jashtëzakonshme në fushën e mjekësisë të kohës moderne këto mendime nuk sillen më vërdallë, dhe nuk merren më si prova që një person me ato tipare të akuzohet dhe të mendohet se mund të jetë i pritur të kryej vrasje apo vepra të tjera kriminale.

Sidoqoftë, për dallim nga teoritë dhe mendimet e para që përshkruanin sjelljet kriminale, duke i përshkruar më shumë nga pamja e jashtme, sot kemi disa teori dhe të dhëna tjera nga psikolog e neuroshkenctarë të ndryshëm që ndajnë mendime të ngjashme.

Përveç teorive se vrasësit janë të lindur me tipare kriminale, ka edhe teori të ndryshme nga fusha e psikologjisë e që janë me rëndësi të veçantë për shpjegimin e sjelljeve kriminale. Ndër teoritë më të njohura psikologjike lidhur me kriminalitetin përmenden teoria e papërshtatshmërisë, teoria e imitimit, teoria e inteligjencës, tepria psikoanalitike, teoria e frustimeve psikike etj.<sup>19</sup>

Marrëdhënia midis psikopatisë dhe vrasësve serial është veçanërisht interesante. Të gjithë psikopatët nuk bëhen vrasës serikë. Përkundrazi, vrasësit serial mund të kenë disa ose shumë nga tiparet në përputhje me psikopatinë. Psikopatët që kryejnë vrasje seriale nuk e vlerësojnë jetën njerëzore dhe janë jashtëzakonisht të pashpirt në ndërveprimet e tyre me viktimat e tyre. Kjo është veçanërisht e dukshme në vrasësit serialë të motivuar seksualisht, të cilët në mënyrë të përsëritur shenjtërojnë, ndjekin, sulmojnë dhe vrasin pa ndjenjën e pendimit<sup>20</sup>. Sidoqoftë, vetëm psikopatia nuk mund të shpjegon si e vetme motivimet e një vrasësi serik sepse ka vrasës

---

<sup>18</sup> Halili. R “Kriminologjia”, Prishtinë, 2016, fq. 78

<sup>19</sup> Po aty

<sup>20</sup> Morton. R (et al). “Analysis Unit-2, National Center for the Analysis of violentcrime”, (2005)  
<https://www.fbi.gov/stats-services/publications/serial-murder#four>

serik me tipare psikopatike dhe ka psikopatë që nuk kanë kryer asnjë vrasje.

Sipas neuroshkenctarëve truri i vrasësve serik duket ndryshe nga truri i njerëzve që nuk kanë kryer vrasje, po edhe nga ata që kanë kryer vetëm një vrasje, ndryshime të cilat lidhen me mënyrën se si ata përpunojnë ndjeshmërinë dhe moralin.




Figura 1. Një ilustrim nga Revista Frenologjike që tregon vendndodhjen e funksionit mendor siç kuptohej në 1876.

Imazhet e rezonancës magnetike funksionale, ose fMRI, na lejojnë të shohim rrjedhën e gjakut në grupe të mëdha të qelizave të trurit ndërsa ato merren me një ngarkesë të rritur pune në përgjigje të një sfide specifike mendore.

Qëllimi i veprimtarisë neuronale është të mbështesë komunikimin midis qelizave të trurit - e cila ndodh në pikat e kontaktit që quhen sinapse dhe të vendosë qarqe neuronale që qëndrojnë në themel të sjelljes sonë, si të mirë ashtu edhe të keqe.<sup>21</sup>

<sup>21</sup> Haycock. D. "Murderous Minds" Exploring the Criminal Psychopathic Brain: Neurological and the Manifestion of Evil. (2015, prill)



Figura 2. Një model që demonstroi një imazh funksional të rezonancës magnetike (fMRI)

## 2.2 Elementet përbërëse të një vrasësi serik

Vrasësit serialë ndryshojnë në shumë mënyra, përfshirë motivet e tyre për vrasje dhe sjelljen e tyre në skenën e krimit. Sidoqoftë, të pranishmit në një simpozium identifikuan disa tipare të zakonshme për disa vrasës serial, duke përfshirë kërkimin e ndjeshmërisë, mungesën e pendimit ose fajit, impulsivitetin, nevojën për kontroll dhe sjelljen grabitqare<sup>22</sup>. Këto tipare dhe sjellje janë në përputhje me çrregullimin e personalitetit psikopatik. Të pranishmit menduan se ishte shumë e rëndësishme për zbatimin e ligjit dhe profesionistë të tjerë në sistemin e drejtësisë penale të kuptonin psikopatinë dhe marrëdhëniet e saj me vrasjen seriale.

Shpeshherë skenat kriminale të vrasjeve të shumëfishta mund të kenë tipare të çuditshme dhe

---

<sup>22</sup> Morton. R (et al). "Analysis Unit-2, National Center for the Analysis of violentcrime", (2005)  
<https://www.fbi.gov/stats-services/publications/serial-murder#four>

mund të vështirësojnë jashtëzakonisht shumë identifikimin e një motivi. Po ashtu është vështirë të përcaktohet vetëm një motiv, sepse te vrasësit serik mund të ketë motive të shumta që e drejtojnë atë deri te vrasja. Vrasësit serik mund të kenë një apo më shumë motive të cilat mund të dallojnë prej viktimës në viktimë. Të klasifikosh motivet e vrasësve serik sigurisht që duhet vëzhguar mirë skenat e krimit, por çfarë e bënë më të vështirë për organet hetuese zbulimin e vrasësit serik është se niveli i lëndimit të viktimës nuk mund të barazohet fare me ndonjë motiv të vrasësit serik, sepse ata mund të kenë një motiv shumë të ulët si motivin seksual e në fund ta godasin dhe vrasin viktimën e tyre në mënyrën më djallëzore.

Duke pas parasysh se asnjë motiv i vrasësve serik nuk e "arsyeton" vrasjen e tyre, sipas të pranishmëve në simpozium ata vrasin, thjeshtë sepse është ajo që ata e dëshirojnë ta bëjnë po përjashtojnë në këtë rast vrasësit që kanë sëmundje mendore.

Vrasësit serik janë zakonisht persona të zemëruar, që kanë krijuar personalitet negativ dhe janë ushqyer me urrejtje ndaj një grup njerëzish (kryesisht grave) apo edhe shoqërisë në përgjithësi. Ata persona që në njëfarë mënyre kërkojnë vëmendje dhe duan të ndjehen të fuqishëm, duke vrarë viktimat në mënyrë që të kenë ndjesinë e fuqisë.

### **2.3 Zhvillimet e mangëta, Gjenet (ADN)**

Ne nuk mund të kuptojmë se pse dikush do të zgjidhte në mënyrë të përsëritur persona të pafajshëm për të vrarë, për t'i sulmuar seksualisht dhe për t'i maltrejtuar në mënyrën më mizore ashtu siq e bëjnë vrasësit serik. Çdo gjë që e mendojmë dhe mundohemi të arsyetojmë, kalon qdo kufi të mendimit njerëzorë. Ne mundohemi disi të shpjegojmë edhe të kërkojmë diçka që mund ta shpjegojë këtë fenomen të rrallë e shpeshherë sjelljet njerëzore i lidhim me gjentiken. Siç dihet në të gjitha qeniet e gjalla ekziston një gjen. Një gjen është njësi themelore fizike dhe

funkionale e trashëgimisë.<sup>23</sup> Gjenet përbëhen nga ADN-ja.<sup>24</sup> ADN-ja jep udhëzime për qenie të gjallë që kodifikojë proteina. Çdo person ka dy kopje të secilit gjen, një e trashëguar nga secili prind.<sup>25</sup> Shumica e gjeneve janë të njëjta në të gjithë njerëzit, por një numër i vogël gjenesesh (më pak se 1 përqind e totalit) janë paksa të ndryshëm midis njerëzve. Alelet janë forma të njëjtit gjen me ndryshime të vogla në sekuencën e tyre të bazave të ADN-së. Këto ndryshime të vogla kontribuojnë në tiparet unike fizike të secilit person.<sup>26</sup>

Kur flitet për fenomenin vrasës serik, ashtu siç nuk e shpjegon dot as gjenetika sjelljen e mirë të një personi, ashtu është e vështirë të thuhet se një person bëhet vrasës sepse “e ka ne gjenetikë”. Sidoqoftë shkencëtarët kanë zbuluar të ashtuquajturin “gjeni i bukurisë”. Gjenet që mund të ndikojnë në sjelljet psikopatike nuk janë identifikuar. Në fakt, edhe çrregullimet mendore të njohura të cilat kanë marrë vite, shumë kohë kërkimi dhe miliarda dollar shpenzime si: skizofrenia, depresioni i madh, çrregullimi bipolar, autizmi, hiperaktiviteti dhe çrregullimet e vëmendjes që mund të ndikojnë në sjelljen psikopatike nuk janë identifikuar dhe nuk janë lidhur me gjenet “shkaktare të sëmundjeve”. Në vend të kësaj, grupe gjenesesh duket se ndikojnë në zhvillimin e këtyre sëmundjeve.<sup>27</sup>

Gjenet nuk mund të shpjegojnë të gjitha sjelljet e dhunshme. Sigurisht që mund të ketë disa predispozita të caktuara për probleme të caktuara psikologjike, por në shumë raste të vrasësve serik, janë faktorët e jashtëm dhe përvoja gjatë rritjes të cilat kanë një rolë të rëndësishëm në sjelljen kriminale.

---

<sup>23</sup> MedlinePlus (Trusted Health Information for you)

<https://medlineplus.gov/genetics/understanding/basics/gene/>

<sup>24</sup> Po aty

<sup>25</sup> Po aty

<sup>26</sup> Po aty

<sup>27</sup> Haycock. D. “Murderous Minds”, (New York 2014)

## KAPITULLI I DYTË

### 2. Faktorët që ndikojnë në paraqitjen e vrasësve serik dhe djallëzorë

#### 2.1 Sëmundjet mendore

Pothuajse të gjithë që dëgjojnë për vrasësit serial, për mënyrën e për motivet që i kryejnë këto vrasje, mendojnë se vetëm një i çmendur apo një i sëmurë nga mendja mund të veproj ashtu. Sidoqoftë si të çmendur u referohemi më shumë personave që vuajnë nga një psikozë që sipas psikiatërve është e lindur e që ka të bëjë me skizofreni, çrregullimin iluzion e psikoza depresive. Ajo që është jashtëzakonisht e zakonshme në mesin e vrasësve serial është një çrregullim psikiatrik (më pak i rëndë) i një lloji, veçanërisht një mos vlerësim i personalitetit.<sup>28</sup>

Edhe pse në disa pika vrasësit serial nuk mund të jenë krejtësisht “të çmendur”, siç mendohet, duke u bazuar në atë se shumica e tyre kanë ide dhe qëllime të sakta se çfarë duan të bëjnë, sipas studiuesit të vrasësve recidivist Michael Stone i cili shpjegon një diversitetet të radhitur lidhur me faktorët që ndikojnë në sjelljet kriminale nuk mundë të thuhet se disa nga ato tiparet që quhen çrregullime të personalitetit nuk janë prezent tek vrasësit serik, si sjellja anti-sociale, narcizmi, personaliteti sadist ose psikopatik, nervozat të egra dhe shpërthyesë.<sup>29</sup> Pra, në secilin vrasës serik kemi disa nga këto tipare, madje edhe kombinime të dy apo më shumë çrregullimeve personaliteti.

Është e vështirë të vendosësh vrasësit serik në grupin e personave që vuajnë nga sëmundjet mendore, sepse gjatë intervistimeve të vrasësve serik, në momentin që mblidhen provat dhe kuptohet mënyra djallëzore e kryerjes së veprës, ata për të shpëtuar nga dënimet e rënda, fillojnë të shtiren sikur janë krejtësisht të çmendur, sikur dëgjojnë zëra nga brenda që shtyjnë të vrasin e gjëra të tjera që nuk arsyetojnë fare veprat e tyre, por e bëjnë në mënyrë që të shpëtojnë nga dënimet e rënda.

---


<sup>28</sup> Stone. H. “The Anatomy of Evil”, New York (2017)

<sup>29</sup> Po aty

## 2.2 Çrregullimet e vëmendjes

Për krijimin e personalitetit të një individi, në këtë raste të personaliteteve kriminale rëndësi e veçantë i kushtohet viteve më të ndjeshme të fëmijërisë së tyre. Dihet se abuzimi, neglizhenca, mos përkushtimi te fëmijët që janë në rritje, truri i të cilëve formohet nga përvojat krijojnë një anomali në qarqet e trurit, mund të çojë në psikopati, hiperaktivitet, çrregullime të vëmendjes e abuzim të drogës.

Si shembull do të merret një vrasës serial, i shfaqur në mesin e viteve të 80-ta në Los Angjelos (SHBA) e që do të njihet si “The night Stalker”



Bëhet fjalë për Richard Ramirez i rritur në El Paso, Texas në një familje Meksiko-Amerikane, më i vogli nga pesë fëmijët. Babai, gjyshi e stërgjyshi i tij ishin të gjithë abuziv ndaj fëmijëve të tyre, e që sipas tyre ishte e nevojshme në mënyrë që të kishte disipline në familje. Vëllezërit e Richard-it kishin telashe me ligjin për varësinë nga droga. Ramirez në fëmijërinë e tij pësoi dy lëndime të rënda; një herë kur një komod i ra përmbi sa ishte duke u ngjitur në të dhe njëherë në këndin e lodrave. Që nga atëherë ai kishte vazhdimisht kriza të çuditshme, ishte më agresiv,




më i distancuar dhe herë herë kishte vizione të sëmura. Në moshën e adoleshencës fillojë të konsumoj droga hallucinogjene si kokaina, LSD dhe Agel dust.

Richardson kishte një kushëri, i cili kishte shërbyer në Vietnam. Ai i tregonte ngjarjet që kishin ndodhur atje, si përdhunonin dhe si i vriste femrat. Për Richardson këto gjëra tingëllonin shumë interesante dhe kushëriri i tij i cili kishte vrarë edhe bashkëshorten e tij, i dukej si një hero. Richard vetëm se kishte krijuar një personalitet të çuditshëm, me një sjellje shumë dyshuese dhe të çorientuar.

Ai fillon vrasjet e tij më ndryshe se vrasësit serial të tjerë, duke hyrë natën nëpër shtëpi të panjohura, për të vrarë e për të dhunuar, kryesisht gra të moshave të ndryshme. Ai do të zbulohej pas vrasjes së tij të katërmbëdhjetë.

Stone e përfshin Ramirez në grupin e vrasësve me çrregullim të vëmendjes sepse ai është nga ata pak vrasës serik historia e të cilit përmendet dhe shpjegohet qartë se si personaliteti i tij kriminal u krijua. Ai hynë në grupin e vrasësve më “djallëzorë” në historinë e vrasjeve serike i cili do bëhej i famshëm si “Night Stalker”, gjë që atë e bënte shumë krenar dhe ndihej sikur kishte një rëndësi të veçantë sepse më në fund e gëzonte atë “vëmendjen” që nuk e kishte pasur kurrë në fëmijëri.




## 2.3 Hiperseksualiteti

Për hiperseksualitetin nuk mund të themi se ekziston një definicion që mund ta shpjegojë saktë se çfarë është, për arsye se hiperseksualiteti mund të jetë i ndryshëm dhe mund të shfaqet ndryshe tek çdo person që vuan nga kjo “sëmundje”. Megjithatë kemi teori të ndryshme rreth hiperseksualitetit.

Çrregullimi seksual, nevoja e tepërt për të pasur marrëdhënie seksuale tek vrasësit serial mund të sjellë pasoja si te vetë ata ashtu edhe te viktimat e tyre, sepse për të përmbushur nevojën e tyre ata rrëmbejnë e madje edhe vrasin shumë njerëz.

Ndër vrasësit serik që ishte bërë i njohur me historinë e tij të krimit në fund të viteve të 90-ta ishte Leonard Fraser, i lindur në vitin 1951 në Australinë veriore. Një vrasës me fëmijëri abuzive, i shënuar si person hiperseksual (heteroseksual më shumë se homoseksual), sfidues dhe i pakontrollueshëm.<sup>30</sup>



Në moshë të re ai filloi të dhunojë djemtë që ishin më të vegjël se ai, ndërsa kur u lirua në moshën 17 vjeçare, ai filloi të dhunojë edhe gra. Ai abuzoi me alkoolin dhe drogën, vodhi një

---

<sup>30</sup> Stone. H. M. “The Anatomy of Evil”, (Serial killers and Tortures) New York (2017)

makinë dhe në një moment përdhunoi dhe vrau një turist francez. Ai vazhdoi në këtë mënyrë derisa u arrestua për përdhunim në moshën njëzet e tre vjeç.<sup>31</sup>

U dënua me njëzet e një vjet burg, ai megjithatë u lirua me kusht për arsye se ishte diagnostikuar si psikopat nga psikiatri i burgut. Arrestohet përsëri për përdhunim menjëherë pas liritimit dhe dënohet me vetëm një muaj burg. Pas disa udhëtimeve jashtë dhe brenda burgjeve, ai përdhunon rreth gjashtëmbëdhjetë gra, vret tre nga to dhe një vajzë të moshës nëntë vjeçare. Në librin e tij Michael Stone (studiuues i vrasësve serik) e përshkruan edhe si torturues i kafshëve që gjithashtu kryente akte edhe me kafshë.

Ai kishte mbajtur një grua të mbyllur në një dhomë, të cilën e detyronte të kryente mardhënje me të gjashtë herë në ditë, para se përfundimisht të arrestohej e hiperseksualiteti i tij të merrej më serioz nga autoritetet. Këtë herë e diagnostikuan si një “sadist seksual i pashërueshëm”.

Frasër ka kryer akte që quhen djallëzore dhe të liga. Motivi i tij ishte çlirimi seksual, e si pasojë e këtij motivi, bëhet vrasës serial. Me historinë e tij kriminale duket se nuk kishte ndonjë motiv tjetër dhe e vetmja gjë që aj e mendonte ishte si të përndjekte dhe si të përdhunonte.

## 2.4 Psikopatitë

Nuk mund të thuhet se vrasësit serial e kanë një profil të përgjithshëm. Ata ndryshojnë në shumë mënyra, duke marrë parasysh motivet dhe mënyrë e sjellëve të tyre, jo gjithmonë e kuptimtë në skenën e krimit. Sidoqoftë tek vrasësit serik gjenden disa tipare që i bëjnë të kenë një lidhshmëri me personalitetin psikopatik. Këto ngjashmëri, përfshijnë: kërkimin e ndjeshmërisë, mungesën e pendimit ose fajit, impulsivitetin, nevojën për kontroll dhe sjelljen grabitqare.<sup>32</sup>

Në historinë kriminale si vrasës serik me këto llojë tipare, mund të veçohet Paul Bernardo.

---

<sup>31</sup> Po aty

<sup>32</sup> Morton. R (et al). “Analysis Unit-2, National Center for the Analysis of violentcrime”, (2005)  
<https://www.fbi.gov/stats-services/publications/serial-murder#four>



Paul Bernardo ishte një fëmijë i cili u rrit nga një nënë që nuk kujdesej për të e nga një baba të sëmurë dhe natyrë negative. Si fëmijë, ishte ngacmues dhe përfshihej në mashtrime të ndryshme, për të përfituar para. Kur mbushi gjashtëmbëdhjetë vjet, nëna e tij e informoj se burri i saj nuk ishte babai i tij biologjik. Nga atëherë, ai u rebelua dhe u bë abuzues ndaj nënës së tij. Ai kishte një varg të dashurash e në lidhje ishte shumë xhelozë dhe abuziv me të dashurat e tij. Ai u fiksua me përdhunimet, seksin anal dhe fantazitë e pushtetit.<sup>33</sup>

Në moshën njëzet e tre vjeç ai takon Karla Homolka-n e cila bëhet skllave e më vonë edhe gruaja e tij. Paul u përfshi në shumë akte vojarizmi, pedofili, rrëmbimesh dhe vrasjesh dhe ishte përgjegjës për vrasjen e tre grave.<sup>34</sup>

Sipas studiuesit të rastit të Paul-it Stone viktima e tij e parë e njohur ishte kunata e tij, Tammy. Paul e bindi gruan e tij Karlen, të i jap motrës së saj anestezion në mënyrë që aj të kishte mardhënie seksuale me të. Si pasoj e kësaj Tammy vdiq, por Karla dhe Paul e bënë të dukej sikur aksident dhe shpëtuan nga dënimi.

Paul e kërcënonte gruan e tij me disa video seksuale që i kishte bërë asaj, në rast se do të kthehej ndonjëherë kundër burrit të saj. Paul e kishte rrahur Karlën, e kur ajo dorëzoi provat autoriteteve, Paul u dënua me burg të përjetshëm, ndërsa Karla u lirua në vitin 2006.

---

<sup>33</sup> Stone. H. M. "The Anatomy of Evil", (Serial killers and Tortures) New York (2017)

<sup>34</sup> Po aty

Se Paul ishte një vrasës serik me personalitet psikopatik e arsyeton edhe një ngjarje që kishte rrëfyer bashkëshortja e tij, kur Paul i kishte prerë kokën një kafshe shtëpiake si “ndëshkim” dhe e kishte detyruar ta gatuate dhe për ta ngrënë.

## 2.5 Personalitet sadist

Çdo njeri mund të jetë agresiv, të ketë fantazi të shfrenuar e të imagjinojë torturën, por kjo nuk do të thotë që çdo kush që i mendon këto gjëra është psikopat apo mund të jetë vrasës serik. Secili njeri e di që këto janë mendime të gabuara dhe në mënyra të ndryshme arrijmë të kontrollojmë anën negative që secili e ka në brendësi. Sidoqoftë te vrasësit serik, kjo gjë nuk ndodh. Duke marrë parasysh motivet dhe mënyrat se si vriten viktimat e tyre, na bënë të kuptojmë që te këta persona kontrolli dhe kufiri midis imagjinatës dhe realitetit nuk ekziston.

Ata përmbushin pothuajse çdo dëshirë dhe çdo mendim që kanë.

Krimet që e bëjnë secilin të mendoj se si është e mundur që dikush të bëjë një gjë të tillë e ta quaj vrasësin djallëzorë, janë krimet që kanë tipare sadiste.


Disa nga tiparet sadiste janë tregues më të fortë se të tjerët. Gëzimi për vuajtjet e të tjerëve është tipari kryesor, por gënjeshtria apo mashtrimi për të tjerët në mënyrë që të shkaktojë dhimbje (mashtrimi i viktimës për të shkuar në ndonjë vend të largët ose të fshehtë, ku sadisti mund të bëjë punën e tij pa u zbuluar) është po ashtu një tipar tjetër i rëndësishëm<sup>35</sup>. Një cilësi e tretë e rëndësishme është frikësimi i të tjerëve nga kërcënimet dhe mizoria<sup>36</sup>. Pra disa vrasës serik përveç që vrasin ata torturojnë viktimat e tyre në mënyra dhe me mjete të ndryshme, në kohë të gjatë, duke u kënaqur dhe duke u përmbushur me dhimbjen e tyre.

Ndër vrasësit serik që kishte tipare të shumta sadiste ishte David Parker Ray.

---

<sup>35</sup> Stone H. M “The Anatomy of Evil”(Serial Killers and Tortures) New York (2017)

<sup>36</sup> Po aty



Mendimi se te pothuajse të gjithë vrasësit serik ekziston tipari sadist, nuk përjashtohet. Por nëse mund të veçohen vrasësit më mizorë dhe më sadist nga të gjithë vrasësit, padyshim ndër ata që njihen deri më tani, David Parker Ray zë vendin e parë. David Parker Ray lindi në Meksikë, në vitin 1939. Babai i tij ishte alkoolist dhe me temperament të dhunshëm. Prindërit e tij u divorcuan kur ai ishte vetëm dhjetë vjeç dhe nëna e tyre i braktisi duke i lënë David-in dhe motrën e tij në duart e gjyshërve. Gjyshi i tij ishte i rreptë me të dhe kishte një kod veshje për David-in, gjë për të cilën do të bullëzohej nga shokët e klasës. Davidi ishte fëmijë i distancuar dhe i vetmuar, por nuk ishte nga ata fëmijët e abuzuar seksualisht.

Në vitet e tij të dyzeta ai kishte filluar të kidnapoj dhe torturojë femra, por ishte ndër ata vrasësit të zgjuar, te të cilët nuk mund të gjendeshin prova. Në pamje të jashtme dhe me punëdhënësit e tij figuronte si një njeri i zakonshëm, i këndshëm dhe i dashur.

Ai kishte punuar punë të ndryshme dhe nuk dihej sakte se kur kishte filluar me aktet e tij dhe kur është shndërruar në një vrasës sadist “profesionit”, por në fillim të viteve 1990-ta ai kishte ndërtuar një dhomë torturash brenda një rimorkioje, të cilën ai e quante “The Toy Box” (kutia e lodrave), të cilën e kishte izoluar që të mos dëgjoheshin zërat. Hapësira ishte pesëmbëdhjetë me njëzet e pesë metra tërësisht e përkushtuar ndaj torturave seksuale. Ray kishte vizatuar fotografi të asaj që ai planifikonte t'u bënte viktimave dhe për të realizuar vizionet e tij ai kishte mbledhur një numër instrumentesh kirurgjikale për të shkaktuar lloje të ndryshme mundimesh. Ai gjithashtu përdori manualë mjekësorë, posaçërisht kushtuar anatomisë femërore. Ai

gjithashtu kishte një pajisje elektrike të bërë në shtëpi që synonte qartë shkaktimin e dhimbjeve dhe një numër shiringash dhe mjetesh për të mbajtur një person nën kontroll. Pastaj kishte vegla të dukshme seksuale, të tilla si dildo të mëdha, rripa dhe kamxhikë.<sup>37</sup>

Në vitin 1993 ai kishte krijuar atë që ai e quante "Shiriti hyrës," apo pjesa hyrëse, të cilën viktimat e tij ishin të detyruar ta dëgjonin menjëherë pasi ishin futur në "Shtëpinë e lodrave" të Ray-it. Në vazhdim një fragment i shkurtër nga shiriti hyrës:

*"Zonja ime dhe unë kemi mbajtur skllave seksi për vite me rradhë. Të dy kemi lidhje të çuditshme që përfshijnë përdhunime, lojëra në birucë, etj. ... Fetishet dhe lidhjet tona përfshijnë skllavëri të rreptë dhe pak sadiste ...*

*Do të jesh këtu një muaj ose dy, ose ndoshta tre, nëse na mban të ndezur. Nëse varet nga zonja ime, ne ju mbajmë për një kohë të pacaktuar. Ajo thotë se është po aq argëtuese dhe më pak e rrezikshme. Por personalisht më pëlqen shumëllojshmëria "*<sup>38</sup>

Për zonjën time e kishte fjalën për të fejuarën e tij Cindy Hendy, e cila e ndihmoi në përdhunime e në vrasje.

## **2.6 Neglizhenca prindërore, poshtërimi prindëror dhe joshja prindërore**

Pas arrestimit të një vrasësi serik, pyetja e parë që shtrohet është: Si dhe pse ky person u bë vrasës recidivist ? Ajo që dihet për një person që shfaqë sjellje të mirë apo të keqe është ndikimi nga përvojat jetësore dhe nga disa faktorë biologjik, që u përmenden më lartë.

Shumë njerëz përgjigjen e pyetjes se si një fëmijë i pafajshëm bëhet një vrasës mizorë e gjejnë në mënyrën se si janë rritur, nga rrethanat familjare që janë përgjegjëse për devijim të fëmijës

---

<sup>37</sup> David Parker Ray: The Toy Box Killer

[https://web.archive.org/web/20080528023523/http://www.trutv.com/library/crime/serial\\_killers/predators/david\\_parker\\_ray/3.html](https://web.archive.org/web/20080528023523/http://www.trutv.com/library/crime/serial_killers/predators/david_parker_ray/3.html)

<sup>38</sup> Stone H. M. "The Anatomy of Evil" (Serial killers and Tortures) New York (2017)

dhe për rrugën normale të zhvillimit të tij. Arsyeja pse mendohet se rrethanat familjare ndikojnë në krijimin e vrasësve serik është se në shumicën e rasteve, është shumë e vështirë të gjelesh një vrasës serial të rritur në një familje që mund të quhet "normale". Pothuajse të gjithë janë rritur në rrethana të vështira, janë neglizhuar nga prindërit, janë abuzuar në mënyra të ndryshme nga prindërit, seksualisht dhe fizikisht, rrjedhin nga familje me status të ulët socio-ekonomik, të rritur pa baba ose pa nënë, të rritur nga gjyshërit me disiplina të rrepta, të sëmurë mendorë, nga prindër alkoolist, të adaptuar, të poshtëruar, të bullizuar etj. Sidoqoftë, kjo nuk do të thotë që çdo fëmijë që abuzohet në fëmijëri mund të bëhet vrasës serik. Pra nuk mund të thuhet se është faktori i vetëm që ndikon në krijimin e një vrasësi recidivist, edhe pse mënyra e rritjes luan një rol mjaft të rëndësishëm në krijimin dhe zhvillimin e personalitetit të një personi në moshën madhore.

Në një konferencë të fundit në Mbretërinë e Bashkuar, studiuesja Abbie Marono paraqiti gjetjen nga puna e saj me ish-profilizuesin e FBI-së Joe Navarro se si lloje të ndryshme të abuzimit në fëmijëri mund të përdoren për të profilizuar vrasësit serialë.

Studimi përfshiu ekzaminimin e shoqatës midis 4 tipologjive të vrasësve serialë:

Epshi dhe përdhunimi, Zemërimi, Fuqia dhe përfitimi financiar - dhe Kategori të abuzimit të fëmijëve - psikologjik, seksual dhe fizik.<sup>39</sup>

Rezultatet sugjerojnë që abuzimi seksual ishte potencialisht i lidhur me tipologjitë e përdhunimit / epshit dhe zemërimit. Ajo u shoqërua gjithashtu me një tendencë për mbingarkesë, seks pas vdekjes dhe zhvendosjen e trupit në një vend tjetër nga vendi ku ndodhi vrasja.

Abuzimi psikologjik shoqërohej më shumë me tipologjitë e përdhunimit / epshit dhe përfitimit financiar. Aktet e krimit të shoqëruara me abuzimin psikologjik të fëmijëve kishin tendencë të përfshinin tortura.

Në të kundërt, abuzimi fizik i fëmijërisë u zbulua se shoqërohej me tipologjinë e përdhunimit / epshit, si dhe sjellje të tilla si kryerja e shpejtë e veprimit, lidhja e trupit dhe lënia e trupit në

---

<sup>39</sup> Davies. N. (June 28, 2018) From Abused Child to Serial Killer: Investigating Nature vs Nurture in Methods of Murder



vendin e ngjarjes.<sup>40</sup>

Në librin e tij *Anatomy of Violence* kriminologu Adrian Raine nuk i përfshin vetëm tiparet biologjike si faktorë kryesorë në shndërrimin e një fëmije të pafajshëm në vrasës serik, por bashkon tiparet biologjike me ato mjedisore. Sipas tij disa nga tiparet e mundshme të një vrasësi përfshijnë: të qenit mashkull, dëmtimi i trurit, nëna që pinte duhan gjatë shtatzënisë, fëmijë të ndarë nga prindërit para moshës tre vjeç dhe fëmijë të neglizhuar me të cilët prindërit nuk janë angazhuar në moshë të re.<sup>41</sup>

Profileri i FBI-së Jim Clemente shpjegoi, *"Gjenetika ngarkon armën, personaliteti dhe psikologjia e tyre e synojnë atë, dhe përvojat e tyre tërheqin këmbëzën."*

Një ndër vrasësit serial që ishte trajtuar në mënyrë mizore nga prindërit e tij, është vrasësi famëkeq James Mitchell, i njohur si Mike DeBardleben.



Ishte fëmija i mesëm në një familje amerikane të klasit të mesëm. Babai i tij ishte nënkolonel në ushtri dhe mjaftë ndëshkues me fëmijët e tij. Kur Majk ishte pesë vjeç, për shembull, babai i tij e futi kokën nën ujë si një dënim për sherre të ndryshme të fëmijërisë.<sup>42</sup> Nëna e tij ishte një

---

<sup>40</sup> Davies. N. (June 28, 2018) From Abused Child to Serial Killer: Investigating Nature vs Nurture in Methods of Murder

<sup>41</sup> Merryweather. Ch 15 Serial Killers who had the childhood from Hell, June 20,2017

<sup>42</sup> Stone. H. M. "The anatomy of Evil", (Serial killers and Tortures), New York (2017)

alkooliste kronike e cila po ashtu ishte ndëshkuese me bijtë e saj. Nga tre djemtë e familjes Mike ishte fëmijë më rebel, gjë që i solli më shumë ndëshkime nga prindërit e tij. Nëna e tij përveç që ishte alkooliste ajo ishte një grua që sillte burra në shtëpi nga lokalët, kur babai i Mike ishte larg.

Në rastin e DeBardleben, mizoria prindërore e shoqëruar me devijimin e nënës së tij u bashkua me atë që padyshim është një tendencë gjenetike nga psikopatitë, siç sugjerohet nga rebelimi i tij.<sup>43</sup>

Mike u martua pesë herë dhe ishte jashtëzakonisht brutal ndaj grave të tij.

Në historinë e tij si vrasës serial, ka vrarë rreth njëzet femra në mënyrë mizore.

Urrejtja e DeBardleben djallëzore buronte nga nëna e tij dhe urrejtja që kishte për të. Ai i shikonte gratë vetëm si lavire, djallëzore e të mira për asgjë. Qëllimi i tij ishte që çdo femër që i afrohej ta shkatërronte, sepse ashtu mendonte se e meritonin e me këtë ai ndjente sikur po vriste nënën e tij çdo herë.

Ashtu si mizoria dhe devijimi i njërit prind që ndikojnë në formimin e një personaliteti vrasës dhe sjellje të devijuar, edhe neglizhenca prindërore mund të jetë mjaftë e dëmshme për fëmijët.

Me neglizhencë nënkuptojmë "Çdo akt i fundit ose mosveprimi nga ana e një prindi ose kujdestari që paraqet një rrezik të afërt të dëmtimit të rëndë të fëmijës"<sup>44</sup>.

Neglizhenca nga nëna është më shkatërruese në vitet e para të jetës se sa neglizhenca nga babai, megjithëse mungesa e babait bëhet çështje më serioze në jetën e djemve në vitet përgatitore dhe adoleshente.<sup>45</sup> Të rritesh pa dashurinë e nënës apo babait mund ta privoj fëmijën të ndjejë anën amtare gjatë rritjes, e të krijojë ndjenja negative, të mbushet me inate e zili e të ndjehen sikur janë vetëm objekte të pavlera.

Përveç neglizhencës dhe dhunës edhe poshtërimi prindërorë, është arsye e sjelljes devijuese fëmijërore. Për shembull, sot fëmijët bullizohen në shkolla shumë, mjerisht kjo tregon

---

<sup>43</sup> Davies. N. (June 28, 2018) From Abused Child to Serial Killer: Investigating Nature vs Nurture in Methods of Murder

<sup>44</sup> Psikologjia (November 11,2017)

<http://revistapsikologji.com/neglizhenca-eshte-nje-nga-format-me-te-zakonshme-te-keqtrajtimet-te-femijeve/>

<sup>45</sup> Stone. H. M. "The anatomy of Evil", (Serial killers and Tortures), New York (2017)

neglizhencën e prindërve të fëmijëve që bullizojnë të tjerët. Bulizmi është çështje shumë e ndjeshme që mund ta lëndojë fëmijën jashtëzakonisht shumë, madje në raste të shumta, ka fëmijë që edhe kanë kryer vetëvrasje nga poshtërimi. Fëmijët poshtërohen për shembull për mbipeshën, për mos dije, lidhur me seksualitetin apo ndonjë të metë fizike.

Poshtërimi i vazhdueshëm i fëmijës mund të ul vetëbesimin e tij, duke e bërë të ndjehet i lënduar, i zemëruar e të humb kontrollin.

Te vrasësit serik pothuajse çdo i dyti ka histori të dhunshme familjare, të mungesës së pranisë prindërore dhe të poshtërimin, jo vetëm nga bashkëmoshatarët, por edhe nga prindërit e tyre. Sidoqoftë poshtërimi nuk është justifikim për vrasje, por disa individë krijojnë botën armiqësore dhe nuk e kalojnë atë as në moshën madhore.

Hale në vitin 1994 në: "The role of humiliation an embarrassment in serial murder"<sup>46</sup> (Roli i poshtërimin dhe sikletit te vrasësit serik) diskutoi rolin e poshtërimin në vrasjen seriale. Viktimat janë simbolike, pohon ai. Ato shkaktojnë kujtime të brendshme të turpshme për tu sharë, kërcënuar ose abuzuar që vazhdojnë të zemërojnë vrasësin. Ai fillon në një përpjekje për të ulur ndikimin - por meqë viktima nuk është personi shkelës, nuk ka zgjidhje, kështu që vrasjet vazhdojnë. Vrasësi nuk bën lidhje midis së kaluarës së tij dhe asaj që ai po bën aktualisht. Ai thjesht po përpiket të ndihet i fuqizuar brenda një konteksti të njohur.

Vrasësit serialë, shton Hale, nuk përparojnë nëpër faza normale të zhvillimit, në të cilat dikush mëson të bëjë dallimin midis asaj që kontrollohet dhe asaj që nuk është e mundur. Ata mbeten të irrituar. Disa zhvillojnë një ndjenjë të ekzagjeruar të asaj që duhet të kontrollojnë dhe të ndiejnë turp kur dështojnë. Kur ata përdorin mjeshtërinë si bazë për vetëvlerësimin e tyre, ata vendosen për ndjenjat e përhapura të pamjaftueshmërisë. Ata mund të pjekën në zona të tjera - një aftësi për të gjetur një punë dhe për të mbështetur një familje, për shembull - por jo në zonën social-seksuale.

Sigurisht që poshtërimi prindërorë nuk është arsye për të gjithë vrasësit recidivist, por mund të jetë një motivues për ta, duke u nisur nga fakti që pothuajse të gjithë pas arrestimit, përmendin

---

<sup>46</sup> Hale. R "The role of humiliation an embarrassment in serial murder"

fëmijërinë e tyre, neglizhencën, dhunën e poshtërimin e shkaktuar prindëror, prandaj duhet të i kushtohen vëmendje edhe këtyre faktorëve.

### 3. FAKTORËT E TJERË QË MUND TË KRIJOJNË NJË VRASËS SERIK

#### 3.1 Adoptimi

Në mes të shumë faktorëve të përmendur që ndikojnë në krijimin e një vrasësi serik, disa faktorë shfaqen prezent në shumicën e rasteve të vrasësve serik, por janë edhe disa faktorë të tjerë, dytësorë dhe më të rrallë, por mjaftë të theksuara kur janë të pranishëm, siç është Adoptimi.

Adoptimi është transferimi i përhershëm ligjor i të gjitha të drejtave prindërore nga një person ose çift tek një person ose çift tjetër. Prindërit birësues kanë të njëjtat të drejta dhe përgjegjësi si prindërit biologjikë dhe fëmijët e birësuar kanë të gjitha përfitimet emocionale, sociale, ligjore dhe farefisnore të fëmijëve biologjikë.<sup>47</sup>

Sipas raportit të FBI-së në 500 vrasës serial, rreth 16% ishin të adaptuar.<sup>48</sup>

Edhe pse në shumicën e rasteve të adoptimit, fëmijët gjejnë prindër zëvendësues të dashur dhe të devotshëm të cilët i rrisin me përgjegjësi të madhe dhe arrijnë të i rrisin si njerëz të arsyeshëm e të dashur, nganjëherë të jesh fëmijë i adoptuar mund të shkaktojë edhe probleme e sidomos kur nuk dihet asgjë për prindërit e tyre biologjikë.

Për disa fëmijë të adoptuar, veçanërisht ata me birësime “te mbyllura”, në të cilat regjistrat e tyre të lindjes janë të vulosur, hulumtimi ka treguar se mos dija nga vijnë mund të kontribuojnë në trauma dhe sëmundje mendore.<sup>49</sup>

---

<sup>47</sup> Kids need families and families need support  
<https://www.adoption.on.ca/what-is-adoption>


<sup>48</sup> Stone. H. M. “The Anatomy of Evil”

<sup>49</sup> Barcela. L. (October 30, 2017) “ Is there a connection between Adoptees an Serial Killers?”  
<https://www.aetv.com/real-crime/is-there-a-connection-between-adoptees-and-serial-killers>

Por a është kjo një justifikim për prirjen e dhunës së mëvonshme?

Ndër vrasësit serik të njohur që ishin të adoptuar janë: Joel Rifkin, Charls Schmid, David Berkowitz ( Son of Sam), Ted Bundy, Aileen Wuornos, Boston Strangels.

Për shembull, vrasësi serik David Berkowitz, i njohur si “Son of Sam”, ishte adoptuar nga prindër të dashur, të kujdesshëm dhe jo abuziv. Berkowitz ishte vetmitarë dhe jo aq i shoqëruar. Përjetimi i tij më i rëndë ishte kur i vdiq nëna adoptive, ndërsa nënën e tij biologjike nuk e kishte njohur por e paramendonte si person indiferent. Ai bëhet i famshëm kur fillon të vrasë vajza të reja që i dukeshin indiferente dhe sipas tij të paafta për të qenë nëna të devotshme, duke paramenduar gjithmonë nënën e tij biologjike, ashtu siç e mendonte ai. Pra te ky rast nuk mund të jetë adoptimi arsyeja e sjelljes kriminale, por pasi që nuk dihet për prindërit e tij, shtrohen pyetje se a ka lindur nga prind që ishin abuziv?, A ka abuzuar nëna e tij në shtatzëni me alkool? A kanë qenë të sëmurë? A kanë probleme gjenetike?., sepse jeta e tij pas adaptimit sigurisht që nuk mund të ketë ndikuar në sjelljen e tij kriminale.



Joel Rifkin, po ashtu ndër vrasësit serial të adoptuar, që nuk ishte keqtrajtuar apo abuzuar nga prindërit e tij adoptiv, megjithatë bëhet ndër vrasësit më mizorë në historinë e krimit.



Te vrasësi serik Charles Schmid paraqitet një situatë më ndryshe. Autori John Gilmore në librin e tij *Cold-Blooded: The Saga of Charls Schmid the Notorious "Pied Piper of Tucson"* (True Crime Series) kushtuar vrasësit serik Schmid shkruan se ai ishte adoptuar që në lindje, dhe prindërit e tij ishin të kujdesshëm, por babai i tij ishte nganjëherë edhe i dhunshëm ndaj tij. Charles ishte një gënjeshtar, i pandershëm, i ligë dhe kërkonte gjithmonë situata tronditëse (elemente psikopatike). Në rastin e tij mund të themi se ndikim në sjellën e tij kriminale, janë shkaqet biologjike, që me doemos i ka të trashëguara nga prindërit e tij biologjik dhe mund të themi se edhe abuzimi i babait të tij adoptiv, mund të kenë mjaftuar që aj të bëhet një vrasës serik.

### 3.2 Dëmtimi i kokës

Dëmtimi i kokës është po ashtu një faktor shumë i përhapur te vrasësit serik. Sipas rasteve një në katër vrasës serial kishte dëmtuar kokën në moshë të re ose (më rrallë) një gjendje që prek trurin siç është meningjiti ose edhe temperatura e lartë gjatë moshës së re.<sup>50</sup>

Dëmtimi i kokës në moshë të re tek vrasësit serial sigurisht që shoqërohet me faktorë të tjerë të *lartcekur*, si *neglizhenca prindërore apo edhe abuzimi fizik në moshë të re (të rrahur nga prindërit, me mjete të ndryshme në kokë)* duke shkaktuar dëme në trurin e ndjeshëm fëmijëror e që më vonë sjellë pasoja të tjera serioze si humbja e kontrollit, në marrëdhënie me njerëzit e

---

<sup>50</sup> Stone. M. "The anatomy of Evil"(Serial Killers an Tortures), (New York, 2017)

tjerë, humbje të empatisë ndaj të tjerëve etj., nëse dëmtohet pjesa e trurit që kontrollon këto ndjesi njerëzor.<sup>51</sup>

### 3.3 Parafilitë

Çrregullimet parafilike janë fantazi, nxitje ose sjellje të përsëritura, intensive, seksuale, shkaktimi i vuajtjeve dhe poshtërimi të partneri dhe që përfshijë objekte jonjerëzore, fëmijë ose të rritur që nuk japin pëlqim.<sup>52</sup>

Parafilia pra përfshin eksitim seksual të karakterizuar me fantazi të shfrenuar dhe sjellje seksuale intensive dhe të përsëritura. Personat me parafili është vështirë të diagnostikohen sepse nuk mund të thuhet se hyn në grupin e sëmundjeve. Personat parafilik mund të duken nga pamja e jashtme shumë normalë, të socializuar dhe të shoqëruar, sidomos me fëmijë.

Kur dëgjon për një person me parafili (pothuajse të gjithë këta persona janë burra), publiku mund të reagoj me hutim ose neveri nëse parafilia nuk është e dëmshme.<sup>53</sup> Disa persona mund të kenë aktivitete seksuale që për persona të tjerë janë të pazakonta dhe neveritëse, por kjo nuk do të thotë që secili që ka këto preferenca mund të diagnostifikohet si person parafilik. Parafilia shqetëson nëse rrezikohet personi që është parafilik dhe kur fillon të rrezikojë edhe shoqërinë dhe tregojnë potencial se mund të dëmtojnë fëmijë apo edhe persona të tjerë pa dëshirën e tyre.

Dhjetëra parafili janë përshkruar, por shumica janë të pazakonta dhe të rralla. Më të zakonshmet janë:

- Pedofilia
- Vojerizëm

---

<sup>51</sup> Stone. M. "The anatomy of Evil" (Serial Killers an Tortures), (New York, 2017)

<sup>52</sup> Brown R, G. (July 2019) "Overviel of Paraphilic disorders"

<https://www.merckmanuals.com/professional/psychiatric-disorders/sexuality,-gender-dysphoria,-and-paraphilias/overview-of-paraphilic-disorders?redirectid=10#:~:text=Paraphilic%20disorders%20are%20recurrent%2C%20intense,the%20potential%20to%20cause%20harm.>


<sup>53</sup> Po aty

- Çrregullimi transverstik
- Ekspozicionizmi

Të tjerët përfshijnë çrregullimin e mazokizmit seksual dhe çrregullimin e sadizmit seksual.<sup>54</sup>

Kur bëhet fjalë për parafilinë te vrasësit serik, se si ka arritur të zhvillohet parafilia në ta është ende e paqartë dhe jo mjaftë e kuptueshme. Sikur pothuajse të gjithë faktorët negativë që ndikojnë në çrregullim të personalitetit të personit, që ishin të shoqëruara me gjenetiken dhe rrethanat familjare, ashtu edhe parafilia mund të jetë një faktorë që shoqërohet me këto dy dukuri të rëndësishme. Personat me më shumë se një parafili kanë përjetuar ngacmime seksuale në ndonjë mënyrë në moshën fëmijërore. Por kjo nuk qëndron gjithmonë, për arsye se në historinë e krimin të vrasësve serik, jo të gjithë ishin keqtrajtuar në fëmijëri por prape se prape në ta ishte zhvilluar një apo më shumë parafili, sipas profesorit të Psikiatrisë klinike, në Kolegjin Culumbia të Mjekëve dhe Kirurgëve, Michael H. Stone.

Për vrasësin serik Tommy Lynn Sells, qëndron teoria se faktori biologjik dhe rrethanat jetësore kanë pasur ndikim të madh në krijimin e personalitetit të tij dhe krijimin e parafilis si sadist seksual, sepse si fëmijë ishte keqtrajtuar në çdo mënyrë të mundshme.



Dennis Rader një tjetër vrasës serik nuk kishte të kaluar abuzive por në të zhvillohen parafili të ndryshme duke filluar nga ato më pak të dëmshme si transvestizëm (më shumë në moshë të re)

---

<sup>54</sup> Stone. M. "The anatomy of Evil" (Serial Killers an Tortures), (New York, 2017)



e deri te pedofilia, skllavëria dhe sadizëm seksual.<sup>55</sup> Ajo çka e dallon Rader-in nga vrasësit e tjerë serik është se ai kishte praktikuar parafilit e tij për një kohë të gjatë duke jetuar një jetë të dyfishtë. Në njërin anë ishte një bashkëshort i dashur, baba i zakonshëm i dy fëmijëve dhe kryetar në kishë, ndërsa në anën tjetër ishte një pedofil e vrasës mizorë që me zgjuarsi kishte arritur ta fshehte anën e tij djallëzore si nga bashkëshortja dhe fëmijët ashtu edhe nga shoqëria të cilët e njihnin si njëri i zgjuar, me sjellje të mirë e si një baba i zakonshëm.

Arsyeja pse Rader është shembull pikërisht te parafilitë, si faktorë që mund të krijojnë një vrasës serik, është se Rader nuk dukej më ndryshe se një person i zakonshëm familjar, e në bazë të kësaj kuptojmë që personat me parafili mund të jenë në mesin tonë, e në asnjë mënyrë mos t'a shprehin në shoqëri.

### 3.4 Treshja (Triada)

Treshja apo triada nënkupton një grup prej tre faktorësh, të cilët konsiderohen të jenë parashikuese se një person mund të ketë tendencat e dhunshme në të ardhmen e veçanërisht ndërlidhet me veprat seriale.

Termi triadë është përdorur për herë të parë nga psikiatri John. M. Macdonald në "Kërcënimi për të vrarë" një artikull i publikuar në vitin 1963 i cili i referohet idesë se ekzistojnë tre shenja që mund të tregojnë nëse dikush do të rritet për t'u bërë një vrasës serial ose një lloj tjetër kriminel i dhunshëm<sup>56</sup>:

Këto tre shenja janë:

- Të qenit mizor ose abuziv me kafshët, veçanërisht me kafshët shtëpiake, - (vrasje, torturim i qenit apo maces). Të vrasësh apo të torturosh kafshë në fëmijëri, ku pothuajse të gjithë bashkëmoshatarët i duan, i çmojnë dhe i perkëledhin si kafshë shtëpiake nuk mund të konsiderohet si sjellje normale te një fëmijë.

---

<sup>55</sup> Stone. M. "The anatomy of Evil" (Serial Killers an Tortures), (New York, 2017)

<sup>56</sup> Jewell. T. (March 29, 2020) "Can the Mcdonald triad Predict Serial Killers?"

<https://www.healthline.com/health/macdonald-triad>

- Vendosja e zjarrit në objekte ose kryerja e veprimeve të tjera të vogla për zjarrvënës,
- Urinimi rregullisht në shtratit edhe pas moshës pesë vjeçare, kohë kur fëmijët vetëm se fillojnë të kenë kontroll në fshikëzën urinare.

Kjo teori u vërtetua nga një studim i kryer në vitin 1966 nga Hellman dhe Blackman. Studimi aktual u krye në një qendër akute të trajtimit psikiatrik intensiv, ku pacientët referohen nga gjykatat, zyrat me kusht dhe burgjet e qytetit. Tetëdhjetë e katër të burgosur midis 1963 dhe 1964 përbënin mostrën dhe u ndanë në një grup të akuzave penale agresive/ të dhunshme dhe një grup të atyre të akuzuar për kundërvajtje ose krim jo agresiv.

Shtatëdhjetë e katër përqind (74%) e atyre në grupin e veprave të dhunshme të këtij studimi kishin një histori nga trashja ose pjesë të saj ndërsa triada ose një pjesë e saj u dëshmuar në vetëm njëzet e tetë përqind (28%) të ata në grupin e krimit jo të dhunshëm.

Ky studim mbështet triadën si një shenjë patogonomike e cila njofton prindërit dhe bashkësinë që një fëmijë mund të jetë problem në të ardhmen. Ky informacion mund të ndihmojë në parandalimin e veprime të rënda kriminale gjatë moshës madhore me zbulimin dhe menaxhimin e hershëm të atyre fëmijëve të cilët mund të jetë në rrezik për veprimtari të mëtejshme të dhunshme kriminale<sup>57</sup>

### 3.5 Abuzimi me substanca

Abuzimi i alkoolit ose ilaçeve të tjera është i zakonshëm te vrasësit serialë. Pothuajse gjysma (45%) pinin alkool në tepri, dhe 7% të tjerë përdorën droga të tjera, të tilla si marihuana, kokaina ose metamfetamina. Grupi më i madh ka abuzuar ekskuluzivisht me shumë me alkoolin, ndërsa një grupi më i vogël kishin përdorur edhe substanca të tjera të shumta si: alkool


<sup>57</sup> Hellman, D. S. & Blackman, N. (1966). Enuresis, firesetting, and cruelty to animals: A trias predictive of adult crime. American Journal of Psychiatry  
<https://cdn.ymaws.com/www.atapworldwide.org/resource/resmgr/summaries/2-Enuresis-Firesetting-Cruel.pdf>

plus kokainë, LSD ose ndonjë llojë tjetër të drogës.<sup>58</sup>

Njerëzit që kryejnë krime të dhunës zakonisht abuzojnë me substanca për të ngritur vetëbesimin dhe për të realizuar krimin që e kanë në mendjen e tyre, në rast se nuk mund të kryejnë aktin kriminal “me vetëdije të plotë”, por vetëm pasi të kenë abuzuar me substanca të ndryshe. Duke marrë parasysh ndikimin e drogave në trurin e njeriut, për shumicën e vrasësve serik, abuzimi me substanca ishte si një lloje katalizatori dhe kontribues mjaft i madh që u ndihmonte të kryenin punën e tyre djallëzore më lehtë.

Ashtu siç dihet edhe nga jeta e përditshme alkooli shpesh të shtynë të bësh diçka që e ndjen për ta bërë por që pa efektin e saj nuk do ta bëje. Për derisa njerëzit me një mendje të shëndosh e me mendime jo ekstreme arrijnë të bëjnë ndonjë budallallëk nën ndikimin e alkoolit, te vrasësit serik që nuk mendojnë për asgjë tjetër, vetëm për viktimën e radhës, ndikimi i substancave e bënë shumë më të lehtë për ta të realizojnë atë që thjeshtë e ndjejnë, pa ndonjë ndërgjegje apo dhembshuri.

Rasti i studimit: Harold Shipman



Harold Shipman, ishte një mjek i përgjithshëm i cili punonte në Manchester-Angli.

Kur historia e tij e krimit serik shpërtheu në vitin 1998, ai ishte një mjek i njohur dhe i

---

<sup>58</sup> Stone. M “The Anatomy of Evil”(New York, 2017)

respektuar.

Shipman u dënua përfundimisht, në janar 2000, për vrasjen e 15 pacientëve të tij.<sup>59</sup> Por policia kishte hetuar më shumë se 100 vdekje të dyshimta dhe shkalla e vërtetë e krimeve të tij do të dilte vetëm pas gjykimit të tij.

Hetimet arrijnë në përfundim se ai kishte filluar vrasjen e pacientëve të tij si një mjek i ri, në fillim të viteve 1970. Ai kishte vazhduar të vriste për një periudhë të gjatë, rreth 28 vite, deri sa u zu përfundimisht në vitin 1998.

Pasi që periudha e krimit është mjaftë e gjatë, për organet hetuese ishte e pamundur që të japin një numër të sakte të viktimave.

Megjithatë, sipas një raporti në 2005 ai ishte përgjegjës për 250 vdekje të pacienteve.<sup>60</sup>

Shumica e viktimave të tij ishin gra të moshuara dhe të sëmura të cilave u kishte injektuar diamorfinën (heroina) të cilat i linte të flinin dhe u thoshte se vetëm po ndihmonte në lehtësimin e dhimbjeve.<sup>61</sup>

Ai u kap përfundimisht kur numri i certifikatave të vdekjeve që po paraqiste ishte shumë i lartë, i shpeshtë dhe mjaft i çuditshëm.

Para se të fillonte me vrasjet e tij të shumta, në mes të viteve 1970, ai u ekspozua si përdorues i drogës, i varur nga një opium qetësues i quajtur pethidine.

Për mrekulli, Këshilli mjekësor e lejoi atë të vazhdonte praktikën e tij – madje duke hedhur poshtë nevojën për një seancë disiplinore zyrtare.<sup>62</sup>

Ai këtë lloje të drogës nuk e përdori vetëm për nevojën e tij “për qetësim”, por e përdori edhe për të vrarë pacientet e tij, që në shumicë ishin të moshuara, sikur jeta e tyre nuk kishte më vlerë.<sup>63</sup>

---

<sup>59</sup> Wilson. Ch. (25 September 2020) “DEADY DOCTOR, Did UK’s biggest serial killer Harold Shipman get away with murder because we didn’t care about the elderly?  
[DEADLY DOCTOR Did UK’s biggest serial killer Harold Shipman get away with murder because we don’t care about the elderly?](#)

<sup>60</sup> Po aty

<sup>61</sup> Quora “ Which serial killers were addicted to drugs and what did they do in that time?  
<https://www.quora.com/Which-serial-killers-were-addicted-to-drugs-and-what-did-they-do-in-that-time>

<sup>62</sup> Po aty

<sup>63</sup> Wilson. Ch. (25 September 2020) “DEADY DOCTOR, Did UK’s biggest serial killer Harold Shipman get away with murder because we didn’t care about the elderly?

## KAPITULLI I TRETË

### *3. Pse duhet të merremi me këta njerëz?*

Që të kuptojmë motivet dhe sjelljet e pazakonta të kryerësve të vrasjeve e sidomos të vrasësve recidivistë është thelbësore zbardhja e krimit, kapja dhe dënimi i shkelësve.

Duke pasur parasysh se ekziston një numër i madh i shkelësve, ku secili veçohet me llojin e tij të pazakonte, nuk përjashtohet mundësia se mund të ketë edhe kush e di sa lloj vrasës të tjerë serik aty jashtë.

Hetuesit dhe organet kompetente për zbardhjen e rasteve dhe zbatimin e ligjit kërkojnë vazhdimisht module të reja, studiuës të ri të krimit serik që të ndihmojnë në fushën e drejtësisë dhe në zbardhjen e rasteve, marrë parasysh se ka me qindra mijëra vrasje autorët e të cilëve janë të panjohur e që me siguri të plotë në mesin e këtyre vrasjeve të shumta, ka dhe ndonjë vrasës serik i cili vazhdon të vrasë persona të panjohur, për motive të ndryshme apo nga dëshira e vetme për të vrarë.

Është e rëndësishme të studiohet për këto vrasje dhe krimin serial në përgjithësi, sepse studiuësit e ri, mund të paraqesin tipologji të ndryshme, të nxjerrin ndoshta edhe motive të tjera nga studimi që mund të ndihmojnë në hetimin e raste

#### **3.1 Roli prindëror në parandalimin e kësaj dukurie – Masat e parakohshme**

Në kapitullin e dytë u përmend se çfarë ndikimi ka abuzimi dhe neglizhenca prindërore në psikikën e fëmijës dhe si këta faktorë ndikuan në krijimin e personaliteteve dhe jetës të mëvonshme.

Gjatë studimeve të rasteve individuale të disa prej vrasësve serik, shumë prej tyre janë rritur në

---

[DEADLY DOCTOR Did UK's biggest serial killer Harold Shipman get away with murder because we don't care about the elderly?](#)

familje abuzive, kanë qenë dëshmitarë të dhunës në familje apo dhe vetë të abuzuar në forma të ndryshme, fëmijë të neglizhuar në masë të madhe.

Siç dihet neglizhenca dhe abuzimi në moshën fëmijërore mund të sjellë efekte negative në mendjen e fëmijës, në gjendjen emocionale, fizike dhe mendore. Këta fëmijë vështirë mund të krijojnë edhe shoqëri më vonë dhe sjelljet që kanë parë e me të cilat janë rritur mund të i shprehin në lidhje me të tjerët.

Abuzimi shpesh bëhet i dukshëm në vitet adoleshente te shumë vrasës serialë, dhe shumë viktimat të tjera të abuzimit, ata do të vazhdojnë me këtë cikël të dhunës. Termi “cikël i dhunës” përdoret për rastet e abuzimit si mënyrë për të shpjeguar ciklin e vazhdueshëm të dhunës që zakonisht gjendet në historinë familjare të abuzuesit.<sup>64</sup>

Dhuna fizike që përkufizohet nga Organizata Botërore e Shëndetit si “përdorim i vulnetshëm i forcës a fuqisë fizike, si kërcënim ose e aplikuar, kundrejt një tjetri, person ose komunitet duke pasur me gjasë rezultate ose mundësi në dëmtime, vdekje, pasoja psikologjike, keqzhvillim, ose pamundësi”, megjithëse grupi është i vetëdijshëm që përfshirja e “përdorimit të forcës” në përkufizimin e vet shtrihet përmbi kuptimit konvencional të fjalës.<sup>65</sup>

Dhuna në familje po ashtu si faktori kryesor që ndikon në psikologjinë e fëmijës, fatkeqësisht ndër problemet kryesore sociale e një ndër fenomenet më të përhapura në botë zë vend në shumë familje. Ky problem, mjaft i komplikuar fillet e saj i ka në mardhënjet bashkëshortore jo të mira të cilat sjellin më vonë një prindërim të gabuar e të dështuar.

Një shqetësim i madh vihet sot re ndaj efektit negativ të dhunës mbi fëmijët e nga rastet praktike të shtjelluaran në shembujt më lartë, është verejtë që vrasësit e krijuar më vonë të jenë abuzuar në mënyra të ndryshme në fëmijëri.

---

<sup>64</sup> Higgs. T. (2012), “ Jeffrey Dahmer: Psychopathy and Neglect  
<https://epublications.regis.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1240&context=theses>

<sup>65</sup> Krug et al. “World report on Violence and health”, World Health Organization,2002.

### 3.2 Roli i qendrave korrektuese

Personi i dënuar, i cili ka kryer krime dhe sjellje të tjera kriminale për arsye se nuk ka qenë sa duhet i kyçur dhe i adaptuar në kushtet e jetës dhe të punës në shoqëri, gjatë qëndrimit në ent, duhet të mësohet, të edukohet dhe të përgatitet që ato rregulla dhe norma të shoqërisë përsëri t'i aprovojë, t'i respektojë dhe të udhëheqet me to.<sup>66</sup>

Paraqitja e dënimeve me burgim ka qenë një hap i madh drejt humanizmit të reagimit të shoqërisë ndaj kriminalitetit e sidomos të tretmantit ndaj personave të dënuar.<sup>67</sup>

Shërbimet e burgut priten që të punojnë drejt shkëputjes së autorëve të veprave ekstremise të dhunshme (dhe të veprave të tjera të dhunshme) prej veprave të dhunshme në të ardhmen dhe, duke vepruar në këtë mënyrë, t'i përgatisin ata për riintegrim social në komunitet.<sup>68</sup>

Burgjet mund të kontribuojnë në sjelljen e mëtutjeshme të disa persona.

Marrë parasysh shumëllojshmërinë e vrasësve serial, shfaqjen e tyre në mënyra të ndryshme: nga vrasës serik që vrasin për përfitime materiale, të vrasësve serik që vrasin për arsye të stimulimit të tyre seksual deri të vrasësve të pasionuar e vrasës të sëmurë nga mendja, të orientuar në emër të fesë së tyre Sataniste e shumë të tjerë që vrasin pa ndonjë motiv të caktuar, por vetëm kënaqen me vajtjen e viktimës dhe shuarjen e jetës është shumë vështirë të besohet se këta persona mund të ndryshohen dhe të rehabilitohen. Marrë parasysh të dhënat që kemi nga psikologjia deri me tani lidhur me psikikën e vrasësve serik, rehabilitimi konsiderohet i pamundur.

---

<sup>66</sup> Halili. R. (Prishtinë 2014) "Penologjia"

<sup>67</sup> Po aty

<sup>68</sup> UNODC VEP Handbook; and Global Center on Cooperative Security (GCCS), Compendium of Good Practices in the Rehabilitation and Reintegration of Violent Extremist Offenders, October 2018,

### 3.3 Dënimet adekutate për kryerjet e vrasjeve

Ligjet e dënimit me vdekje në Shtetet e Bashkuara nuk i'u adresohen posaçërisht vrasësve serial. Personat të cilët kryejnë krime të rënda u shqiptohet dënimi me vdekje. Një vrasës serik futet në këtë statut në bazë të mënyrës dhe në varësi të rrethanave. Këto rrethana përfshijnë (1) kryerjen e një vrasje për të cilën më parë ishin dënuar për vrasje me dashje ose (2) vrasjen e dy ose më shumë personave në të njejtën kohë ose gjatë një veprimi të vetëm.<sup>69</sup>

Sipas sistemit të drejtësisë çdo person merr dënimin e merituar në poporcion me veprat që kanë kryerë. Pasi që vrasësit serial kryejn krimet më jonjerëzore, të çuditshme dhe të tmerrshme, sipas këtij parimi ata meritojnë dënimin përfundimtar.

Marrë parasysh shembujt e disa vrasësve serik të përmendur më lartë, u pa që shumë prej tyre për një kohë të gjatë i kanë shpëtuar sistemit të drejtësisë, pasi që krimet e tyre i planifikonin dhe i kryenin me kujdes të shtruar.

Dënimi me vdekje është temë mjaftë e diskutueshme, pasi që si dënimi më i rëndë disa e mbështesin e disa e kundërshtojnë me forcë atë. Sidoqoftë vrasja është padyshim një veprë e papranushme për shoqërinë dhe është shkelja më e rëndë në çdo shtet.

Pa dyshim që vrasësit serik vuajn nga çrregullimet psikologjike si psikopati dhe çrregullime të personalitetit, që në gjykatë merren gjithmonë në konsideratë. Në çdo rast mbrojtësit janë të lejuar të përdorin arsyen psikike të të pandehurit, sipas të cilës individi nuk kishte aftësi të kuptojë se çfarë është e drejtë e çfarë e gabuar ose të kontrollojë veprimet e tij në kohën kur është kryer krimi.<sup>70</sup>

Një person nuk është penalisht përgjegjës për sjelljen e tij në rast se gjatë kohës së kryerjes së veprës penale vuante nga një sëmundje mendore, nga e cila nuk mundë të njohë natyrën dhe cilësinë e veprës që ai po bënte, ose nëse ai nuk e dinte se ajo çfarë ishte duke bërë ishte e gabuar.<sup>71</sup> Çmenduria apo sëmundja mendore është një mbrojtje pohuese e cila duhet të

---

<sup>69</sup> Reinhart.Ch. (October 26, 2000) "Death Penalty and Serial killers"

<sup>70</sup> Martin, P. J. (1998). " The Insanity Defense "

<sup>71</sup> Po aty



provohet nga epërsia e provave.<sup>72</sup>

Por sa mund të provohet kjo llojë mbrojte te vrasësit serik, edhe nëse arrihet të mbrohet sa vendim i drejtë do të ishte pas gjithë krimeve që kanë bërë. Shumë njerëz për personat që kryejn vrasje ndjejnë një neveri, edhe nëse viktimat e vrasësve serialë nuk janë miqë ose familjarë tanë, thjeshtë duke ditur gjërat e tmerrshme që viktimat kanë përjetuar nga këta persona ka një ndikim të jashtëzakonshëm në shoqëri. Është arsyeja që në një mënyrë edhe e justifikon dënimin me vdekje.

Mund të analizohen tre argumente justifikuese për dënimin me vdekje sipas Schmalleger, F., (2010). *Criminal Justice: A Brief Introduction* (8th ed).<sup>73</sup>

1. Arsyetimi i hakmarrjes apelon se ata që vuajnë si rezultat i veprimeve të një vrasësi gjakftohtë meritojnë mundësinë për t'u hakmarrë, duke marrë parasysh se vrasësit serial kanë një numër të madh të viktimave, gjë që do të thotë se ka shumë më shumë njerëz të prekur nga veprimet e tyre mizore.<sup>74</sup> Të mbijetuarit, familjarët dhe shoqëria në përgjithësi, vetëm nga ekzekutimi i kryesëve do të shërojnë atë plagën psikologjike dhe shoqërore<sup>75</sup>. E nga ana tjetër janë kundërshtarët e dënimeve me vrasje që besojnë se dy gabime nuk mund të bëjnë në veprim të drejtë.

2. Arsyetimi i dytë thotë se vrasësit serialë meritojnë të vdesin për atë që kanë bërë. Krimet e tyre janë aq mizore sa është e pamundur të ndjesh mëshirë për ta. Në artikull "Dënimi me vdekje - Drejtësia e vetme për vrasësit", Charles Montaldo deklaroi: Me kalimin e kohës, vrasësi i dënuar do të përshtatet me burgosjen dhe do të gjejë brenda kufizimet e saj, koha kur ata ndiejnë gëzim, kohërat kur ata qeshin, flasin me ta familja, etj., por si viktimë, nuk ka më mundësi të tilla në dispozicion të tyre.

Sipas Montaldos, një vrasës nuk mund të presë që të tjerët ta vlerësojnë jetën e tij kur ai ose ajo nuk tregoi respekt për jetën njerëzore. Për viktimat, mënyra më e mirë për të arritur

---

<sup>72</sup> Verniero, P. (2011). *Rules Governing the Courts of the State of New Jersey*. Newark, NJ: Gann Law Books. 200

<sup>73</sup> Schmalleger, F., (2010). *Criminal Justice: A Brief Introduction* (8th ed).

<sup>74</sup> Po aty

<sup>75</sup> Po aty

drejtësinë është të bësh vrasësi të njëjtën gjë që u bëri atyre. Çdo gjë më pak se vdekja nuk mjafton për të treguar drejtësi.

3. Arsyetimi i fundit është mbrojtja, e cila përpiqet të parandaloj sa më shumë vrasje, duke vrarë vrasësit. Sipas këtij arsyetimi nëse kriminelët e rrezikshëm si vrasësit serik, dënohen me vdekje, ata nuk janë më në gjendje të përsërisin veprën e tyre. Ata vuajnë nga defektet të personalitetit dhe nuk mund t'i kontrollojnë ato. Duke qenë të dhunshëm, manipulues dhe kërkimi i akteve tronditëse si pjesë e natyrës së tyre. Meqenëse vrasësit recedivistë nuk janë në gjendje të ndjeshëm pendim për veprimet e tyre, nuk mund të rehabilitohen apo të vendosen përsëri në shoqëri, duke i lejuar të jetojnë, rrisin rrezikun e lëndimit apo vrasjes së rojeve të burgut apo të burgosëve të tjerë.


## KAPITULLI IV

### 4. VRASËSIT SERIK – ASPEKTI KRAHASIMOR

#### 4. 1 Vrasësit serik në SHBA

Në përgjithësi vrasjet seriale që ndodhin nga duart e vrasësve serik janë të jashtëzakonishtë të rralla, krahasuar me vrasjet e tjera, që ndodhin pothuajse çdo ditë nëpër botë.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë më shumë vrasës serik se çdo vend tjetër në botë, në mbi 2,700 raste.<sup>76</sup>



Israel Keyes lindi në 1978 në Richmond, Utah. Ai u shkollua në shtëpi dhe përfundimisht u transferua me familjen e tij në Uashington.<sup>77</sup>

<sup>76</sup> Gabriel. M. "Which State produces the most Serial killers"

<https://www.thefactsite.com/state-with-most-serial-killers/>

<sup>77</sup> Cole. C. " Meet the modern Man: Serial Killer Israel Keyes ( April 10, 2019)

<https://www.thecriminalcode.com/index.php/2019/04/10/meet-the-modern-man-serial-killer-israel-keyes/>

Keyes iu bashkua Ushtrisë në vitin 1998, kur ishte vetëm 20 vjeç. Nga bashkë ushtaret e tjerë ai përshkruhej si person që e mbante veten, por gjatë fundjavave pinte shumë alkool. Megjithatë, ai nuk shkaktoi ndonjë problem gjatë asaj kohe dhe arrin të shkarkohet me nder pas disa vitesh shërbim.

Ne vitin 2007 ishte shpërngulur në Alaska, ku hapi biznesin e tij dhe punoi si kontraktor. Israel Keyes ishte një vrasës serik më i zgjuar se shumica nga vrasësit serik të njohur deri më tani, që zakonisht për të kryer vrasjet e tij udhëtonte në vende të ndryshme dhe nuk kishte një profil të caktuar të viktimave (gjë që e bënë të vështirë për autoritetet të kuptojnë se bëhet fjalë për një vrasës serik), pra viktimat ishin sipas mundësive të tij.<sup>78</sup>

Modesti i Keyes ishte të fluturonte në një zonë tjetër të vendit dhe të merrte me qira një automjet. Pastaj, ai do të voziste nganjëherë qindra milje në pjesë të ndryshme të vendit. Ai do të paguante për benzinën, furnizimet dhe qëndrimet në hotel vetëm me para në mënyre që të mos linte asnjë gjurmë digjitale<sup>79</sup>.

Viktimat i kërkonte në zona të largëta dhe më pak të banueshme. Pastaj do të gjente ndonjë vend të largët për të kryer vrasjet e tij. Pasi kryente vrasjet, ai nuk do të kthehej më kurrë në ato vende.

Ai u kap me viktimën e tij të fundit, për të cilën edhe theu rregullën e tij (të vriste larg dhe asnjëherë në vendin ku jetonte).

Më 12 shkurt 2012, Keyes pa një punëtore në kabinën e kafesë me emrin Samantha Koenig në Anchorage, Alaska dhe vendosi që ajo të ishte viktimja e tij e radhës. Në vend që ta ndiqte me fshehtësi pasi ajo doli nga puna, ai zgjodhi ta rrëmbente. Rrëmbimi ishte kap në video, por organet megjithatë nuk ishin në gjendje ta identifikonin se kush ishte.<sup>80</sup>

Pas kërkimeve të gjata, ishte bërë vonë për viktimën. Ai e kishte kidnapuar, dhunuar dhe vrarë atë afër pronës së tij.

Pas arrestimit të tij, ai u intervistua nga policet dhe FBI, ku pranoi se kishte vrarë së paku 8 persona dhe tregoi detaje se ku i kishte fshehur trupat e pajetë.

---

<sup>78</sup> Cole. C. " Meet the modern Man: Serial Killer Israel Keyes ( April 10, 2019)

<https://www.thecriminalcode.com/index.php/2019/04/10/meet-the-modern-man-serial-killer-israel-keyes/>

<sup>79</sup> Po aty.

<sup>80</sup> Po aty

Pastaj, më 2 dhjetor, saktësisht 9 muaj nga dita kur Keyes rrëmbeu Koenig- ai vrau veten në qelinë e tij të burgut Anchorage.<sup>81</sup>

Zbatimi i ligjit, shqiptimi i dënimit mbeten me shumë pyetje të papërgjigjura për autoritete në lidhje me krimet e tij.

## Ted Bundy



Vrasësi serial dhe përdhunuesi amerikan Ted Bundy ishte një nga kriminelët më famëkeq në fundin e shekullit të 20-të, i njohur për vrasjen e të paktën 36 grave në vitet 1970. Ai u ekzekutua në karrigen elektrike në 1989.<sup>82</sup>

---

<sup>81</sup> Po aty

<sup>82</sup> Ted Bundy biography

<https://www.biography.com/crime-figure/ted-bundy>

Nga jeta e tij e mëhershme dhe nga paraqitjet Bundy u rrit në një familje normale dhe punëtoare. Ai tregoi interes jo të zakonshëm në mjete të ftohta, qysh në moshë të re. Si fëmijë ishte i ndrojtur, por i zgjuar.

Sjelljen e tij kriminale filloj ta paraqes në moshën e adoleshencës.

Bundy u diplomua në Universitetin e Uashingtonit në psikologji në vitin 1972. Ai ishte pranuar në shkollën juridike në Utah, megjithëse nuk u diplomua kurrë nga aty.<sup>83</sup>

Gjatë viteve të studimit në Uashington, Bundy kishte rënë në dashuri me një grua nga Kalifornia. Kur lidhja e tyre mbaroj ai ishte lënduar aq shumë, sa që shumë nga viktimat e tij të mëvonshme do i ngjanin gruas që ai e dashuroj.

Bundy rrëfeu për 36 vrasje të grave të reja në disa shtete në vitet 1970, por ekspertët besojnë se rezultati përfundimtar mund të jetë më afër 100 ose edhe më shumë<sup>84</sup>. Numri i saktë i grave të vrara nga Bundy kurrë nuk do të dihet. Njihet për vrasje në mënyrë të tmerrshme dhe djallëzore: Përdhunim të viktimës, pastaj rrahje deri në vdekje.

Si u zu Ted Bundy ?

Në vjeshtën e vitit 1974, Bundy u zhvendos në Utah për të ndjekur shkollën juridike, dhe gratë filluan të zhdukeshin edhe atje. Vitin pasues, ai u arrestua nga policia. Ata kontrolluan automjetin e tij, ku u gjetën mjete të vjedhura, një turmë, një maskë fytyre, litar dhe pranga. Pasi u arrestua për mbajtjen e këtyre mjeteve, autoritetet filluan ta ngarkonin për krime më të rënda se sa vetëm mbajtja e këtyre veglave të pazakonta.<sup>85</sup>

Në vitin 1975, Bundy u arrestua për rrëmbimin e Carol DaRonch, një nga të paktat gra që i shpëtoj kthetrave të tij.<sup>86</sup>

Bundy ishte arratisur nga burgu dy herë në vitin 1977. Pas arratisjes së tij të dytë, ai arriti në Florida ku në janar të vitit 1978, Bundy hyri në shtëpinë e shoqërisë Chi Omega në Universitetin

---

<sup>83</sup> Ted Bundy biography

<https://www.biography.com/crime-figure/ted-bundy>

<sup>84</sup> Po aty

<sup>85</sup> Po aty

<sup>86</sup> Po aty

shtetërorë të Florida. Ai sulmoi katër banore të reja dhe vrau dy prej tyre. Më 9 shkurt, Bundy rrëmbeu dhe vrau një vajzë 12-vjeçe të quajtur Kimberly Leach.<sup>87</sup>

Në vitin 1979, Bundy zihet përfundimisht dhe dënohet dy herë me vdekje për vrasjen në Chi Omega dhe për vrasjen e vajzës 12 – vjeçare.<sup>88</sup>

Ai ishte një manipulator dhe për të shpëtuar nga karriga elektrike, filloj të jap detaje lidhur me disa vrasje të pazgjedhura. Drejtësia nuk vonohej gjithmonë, dhe Bundy u ekzekutua përfundimisht më 1989.

## **4.2 Vrasësit serik në disa vende të Evropës**

Në këtë punim fokusi ishte te vrasësit serik Amerikan sepse ata siç u përmend dhe më lartë ata përbëjnë numrin më të madh të rasteve. Por jo vetëm në Shtete e Bashkuara kanë ndodhur dhe janë aktivë rastet e vrasjeve serike. Edhe Evropa është përballur me vrasës serik, madje siç është cekur në hyrje të punimit, njëri ndër vrasësit më famëkeqë i cili nuk u identifikua kurrë edhe pse vrasjet e tij kanë ndodhur më shumë se 100 vjet më parë në rrethin Whitechapel të Londrës Viktoriane. Misteri i identitetit të tij është rritur me vite në përmasa të mëdha duke i dhënë një llojë të statusit legjendar, të cilin shumë nga pasardhësit e tij e dëshironin.

Në vazhdim do të merren shembull disa shtete të Evropës të cilat u përballuan me këtë fenomen të rrallë:

### **4.2.1 Gjermania**

Regjistrimi i tmerrshëm fsheh faktin relativisht qetësues se historia gjermane e para luftës është

---

<sup>87</sup> Po aty

<sup>88</sup> Po aty

shumë më e pasur me vrasje seriale se sa dekadad pas Luftës së Dytë Botërore.<sup>89</sup>

Megjithatë edhe në historinë gjermane përmenden emra të disa vrasësve serik që kryen krime të rënda masive edhe në Luftën e Parë Botërore:

Karl Denke vrau 26 burra dhe pesë gra në Luftën e Parë Botërore,

Fritz Haarmann vrau të paktën 26 të rinj në Hanover në periudhën e mesluftës dhe rreth vitit 1920, 23 gra dhe vajza ranë viktime të shitësit të suchukut në Berlin Carl Grossmann.<sup>90</sup>

Rasti më i fundit që kishte ndodhur në Gjermani nuk mund të themi se ishte një vrasje serike në kuptimin e ngushtë të një serie vrasjesh të zakonshme, por në të cilën ndodhi një vrasje masive ishte, më 26 Prill 2002, kur Robert Steinhäuser qëlloi 16 persona në një ditë të vetme, në një shkollë të mesme në Erfurt<sup>91</sup>

Dhe një rast i cili bëri bujë në vitet e 60-ta në Gjermani ishte edhe vrasësi Barsch Jurgen:



---

<sup>89</sup> Frankfurter Allgemeine. Masenmörder "Ein phänomen der Moderne"

<sup>90</sup> Po aty

<sup>91</sup> Po aty



Barsch Jurgen i njohur si “Der Kindermörder”(vrasësi i fëmijëve) – vrau katër fëmijë rreth moshave tetë dhe dymbëdhjetë vjeç.

Ai e kreu vrasjen e tij të parë në vitin 1962, kur ishte vetëm 15 vjeç. Iu drejtua viktimave të tij në panairë dhe i joshi në një strehë të vjetër të sulmeve ajrore. Në tunel ai abuzoi dhe torturoi fëmijët para se t’i vriste. Më 18 qershor 1966, Bartsch gjeti një viktimë të pestë që shpëtoj nga ai. Tri ditë më vonë ai u kap.<sup>92</sup>

Edhe pse Gjermania këtë fenomen nuk e ka dhe aq të përhapur, krahasuar me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sipas një komisionerit Gjerman Harbord i cili hetoi se si gratë bëhen vrasëse serike, dhe çfarë i bënë ato më ndryshe se vrasësit serik meshkuj, shumë autorë të kriminit serik janë ende të pazbuluar dhe shprehet se në Gjermani do të ketë “ende surpriza” lidhur me këtë fenomen. Sipas tij, “Në Gjermani jetojnë rreth 20 vrasëse serike femra ende të pazbuluara”<sup>93</sup>

#### 4.2.2 Norvegjia

Sipas Indeksit Global të paqes, Norvegjia është një nga vendet më paqësore në botë<sup>94</sup> Megjithatë edhe Norvegjia ka hasur dhe vazhdon të ballafaqohet me fenomenin Vrasës serik, disa prej të cilëve tani më janë të njohur e të cilët do të jenë në burg derisa të vdesin, pa ndonjë mundësi lirimi me kusht.

Ndër emrat më të njohur një Norvegji të vrasësve serik dhe të atyre masiv janë:

Fritz Moen	Nr. i viktimave te identifikuara: 2
------------	-------------------------------------

<sup>92</sup> Rückschau: Sendung von Donnerstag 18.05.2020

[https://web.archive.org/web/20110716145509/http://www.daserste.de/kriminalfaelle/sendung\\_dyn~uid%2Cuqk\\_ywjak0oqysllwnauba2q6~cm.asp](https://web.archive.org/web/20110716145509/http://www.daserste.de/kriminalfaelle/sendung_dyn~uid%2Cuqk_ywjak0oqysllwnauba2q6~cm.asp)

<sup>93</sup> Welt “ In Deutschland leben 20 Serienmörderinnen unbekannt” (2017)

<https://www.welt.de/vermischtes/article162476388/In-Deutschland-leben-20-Serienmoerderinnen-unerkannt.html>

<sup>94</sup> Norway is “The least peaceful” Nordic country

<https://www.thelocal.no/20160610/norway-is-the-least-peaceful-country-in-the-nordics/>

Peter Westerstrom	Nr. i viktimave: 4
Thomas Quick	Nr. i viktimave: 8-15
Belle Guinness	Nr. i viktimave: 13-40+
Arnfinn Nesset	Nr. i viktimave: 22-138+
Hassan Abdi Dhuhulow	Nr. i viktimave: 63
Andres Behring Breivik	Nr. i viktimave 77

### 4.2.3 Franca



Vincenzo Aiutino – një punëtor 28-vjeçar i akuzuar për përpjekjen për përdhunimin dhe vrasjen e tre grave. Ai pranoj se vrau një të cilën akuzohej Bernadette Bour, një 40-vjeçare në vitin 1992, ndërsa mohoj përfshirjen në vrasjen e dy vajzave të tjera të moshës 20 dhe 21 në vitin 1991.

## 4.3 Vrasësit serik në vendet e rajonit

### 4.3.1 Maqedonia e Veriut



Kur tre gra - Mitra Simjanoska, Ljubica Licoska dhe Zivana Temelkoska - vriten në qytetin maqedonas të Kërçovës, gazetari vendas Vlado Taneski merr përsipër të shpjegojë me hollësi historitë, pa e ditur që policia kishte vu syrin në të si i dyshuar për vrasjet.<sup>95</sup>

Ai publikoj artikuj në lidhje me vrasjen e tre zonjave që punonin si pastruese. Shkrimet e tij përmbanin detaje që nuk i kishin bërë publike policia dhe të cilat mund të diheshin vetëm nga vrasësi.

Gazeta e njohur the Guardian në një artikull kushtuar Gazetarit Tanesk, me titullin “The shocking Story of the Newspaper crime reporter who knew too much” (Historia tronditëse e Gazetarit i cili dinte shumë), pulikuar në vitin 2008 shkruan për rastin:

Pasi artikujt ngjallën dyshime, policia filloi hetimin e Tanesk-it, i cili ishte një gazetarë i respektuar për më shumë se 20 vjet. Ai u arrestua pasi ADN-ja e tij përputhej me spermën e

---

<sup>95</sup> Case 108 “The Kicevo Monster”  
<https://casefilepodcast.com/case-108-the-kicevo-monster/>

gjetur tek viktimet, trupat e të cilëve u zbuluan të zhveshur, të mbështjellë me kablllo telefonike dhe të mbuluara në çanta najloni në vende të ndryshme në Kërçovë, një qytet i varfër, malor rreth 120 kilometra, ose 75 milje, në jugperëndim të Shkupit.

Dhe, duke shtuar faktin se viktimat ishin pastruese, siç ishte nëna e vdekur e Taneski, policia vuri në dukje që të tre kishin një ngjashmëri të jashtëzakonshme me nënën e tij me të cilën vrasësi besohet të ketë pasur një mardhënie të trazuar, e cila u përkeqësua ndjeshëm pasi babai i tij vrau veten në 1990.

Taneski u gjet i vdekur në qelinë që po ndante me dy të burgosurit e tjerë me kokën e tij në një kovë plastike me ujë.<sup>96</sup> Policia tha se vdekja dukej se ishte një vetëvrasje.

---

<sup>96</sup> Case 108 “The Kicevo Monster”  
<https://casefilepodcast.com/case-108-the-kicevo-monster/>

## PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Forma më e rrallë e vrasjeve është vrasja serike. Pavarësisht asaj se çfarë shohim në CSI ose në dokumentarët e ndryshëm për vrasësit serik, njerëzit që vrasin rastësisht dhe pa ndonjë arsye nuk janë dhe aq të zakonshëm. Sidoqoftë kjo formë e krimit është mjaftë tërheqëse dhe interesante për ta përcjelle.

Pse kjo dukuri e rrallë i fascinon njerëzit të pëlqejnë të shikojnë dokumentarë, filma, të lexojnë dhe studiojnë për vrasjet serikë.

Kjo magjepsje më vrasësit serik bazohet në nevojën për të kuptuar pse dikush është në gjendje të bëjë gjëra kaq të tmerrshme dhe djallëzore ndaj njerëzve që ndoshta kanë qenë në kohën dhe në vendin e gabuar, e që për ta janë njerëz kryesisht të huaj. Në mundohemi t'u japim kuptim veprimeve të tilla dhe mundohemi ta kuptojmë botën e tyre, por te vrasësit serik është mjaftë e vështirë të kuptohen apo të arsyetohen veprimet e tilla sepse sado që mundohemi t'i kuptojmë, gjithçka bie dhe kalon kuptimet tona logjike.

Ndonëse shmangja totale nga paraqitja e kryerësve të vrasjeve serike nuk mund të sigurohet, ajo çfarë mund të jetë e rëndësishme është edukata dhe kujdesi i mirë, sidomos nga prindërit.

Lidhur me temën e punimit propozoj:

- Mbajtja e ligjëratave lidhur me temën për psikologji kriminale, e veçanërisht t'i kushtohet vëmendje faktorëve që ndikojnë në krijimin e vrasësve serik.
- Shoqëria duhet patjetër të vetëdijesohet për pasojat që sjella e tyre negative, ngacmimi apo përqeshja e tjetrit mund të ketë te një person.
- Të shtohen kontrolli nga qendrat sociale (të bëhen kontrolli në familje te të cilat dyshohet se fëmijët nuk rriten si duhet, keqtrajtohet, poshtërohen apo neglizhohen nga prindërit)
- Të ndërmerren masa në penalizmin e personave përgjegjës që ndikuan në krijimin e vrasësve serik
- T'i kushtohet rëndësi e veçantë personave me çrregullime mendore, seksuale, parafili e psikopati nga institucione shoqërore, sepse në fund ata janë persona që kanë nevojë për ndihmë.
- Të punohet më shumë në vlerësimin dhe sjellën pozitive shoqërore.

- Të punohet më shumë në ndalimin e bullizimit nëpër shkolla
- Filmat, dokumentarët e artikuj të fokusohen te faktorët që ndikojnë në krijimin e personaliteteve jonormale.

## LITERATURA

- Callahan M. "American predator-*The hunt for the most meticulous serial killers of the 21 century*", United States of America by Viking, 2019
- Stone H. M. "The anatomy of Evil", United States of America, 2009
- Dean A. Haycock, Ph.D. "Murderous Minds – Exploring the Criminal Psychopathic Brain", New York, 2014
- Latifi V. "Kriminalistika", Prishtinë, 2014
- Halili R. "Kriminologjia", Prishtinë, 2016
- Ramsland K. "Inside the Minds of serial Killers: Why the Kill"
- Sahw J. "The journal of Forensic Psychiatry & Psychology", (*Female serial killers in the United States: means, motives and makings*), 2016
- John Wiley&Sons, Ltd, "Criminal Behavior and Mental Health", 2006
- Journal of Punjab Academy of Forensic Medicine&Toxicology, 2009
- Behavioral Sciences and the Law, 2001
- Journal of Investigative Psychology and Offender Profiling, J.Investig, Psych. Offender Profil, 2004
- A geographical analysis of German serial killers. J Investig Psychol Offender Profil, 2019
- Simon I. R, "Serial Killers, Evil and Us".
- Knight G. Z. - Journal of Sexual Aggression, *Sexual motivated serial killers and psychology of aggression and "evil" withing a contemporary psychoanalytical perspective*, Zelds G. Knight, Department of Psycholog, Rhodes University, Grahamstown, South Africa, March 2007
- Knight G. Z. - Social Behavior an Personality, *Some thoughts on the Psychological roots of the behavior of Serial Killers or Narcissist: An Object Relations Perspective*, Zelda G. Knight, Rhodes University, Grahamstown, South Africa, 2006.
- Vronsky. P. - Serial Killers: The Method and Madness of Monsters, Peter Vronsky, 2004

## **Burime nga interneti**

<https://www.psychologytoday.com/us/blog/you-me-psychology/202011/are-serial-killers-born-or-made>

<https://www.fbi.gov/stats-services/publications/serial-murder#three>

<https://news.uchicago.edu/story/scientists-studied-brains-more-800-prisoners-heres-what-they-found>

[https://www.scielo.br/scielo.php?pid=s1516-44462006000600005&script=sci\\_arttext&tIng=en](https://www.scielo.br/scielo.php?pid=s1516-44462006000600005&script=sci_arttext&tIng=en)

<https://sq.evidentista.org/120574-7836>

<https://scholarworks.waldenu.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=9882&context=dissertations>

[https://web.archive.org/web/20080528023523/http://www.trutv.com/library/crime/serial\\_killers/predators/david\\_parker\\_ray/3.html](https://web.archive.org/web/20080528023523/http://www.trutv.com/library/crime/serial_killers/predators/david_parker_ray/3.html)

<https://www.psychiatryadvisor.com/home/topics/violence-and-aggression/from-abused-child-to-serial-killer-investigating-nature-vs-nurture-in-methods-of-murder/#:~:text=4-,A%20landmark%20study%20of%2050%20serial%20killers%20found%20that%20childhood,prevalent%20in%20lust%20serial%20killers.&text=There%20was%20also%20evidence%20of,demonstrate%20violence%20later%20in%20life.>

<https://www.thetalko.com/15-serial-killers-who-had-the-childhood-from-hell/>



<https://www.psychologytoday.com/us/blog/shadow-boxing/201909/shame-and-the-serial-killer>

<https://www.aetv.com/real-crime/is-there-a-connection-between-adoptees-and-serial-killers>

<https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S1359178914000305>

<https://ajp.psychiatryonline.org/doi/abs/10.1176/ajp.120.2.125>

<https://www.quora.com/Which-serial-killers-were-addicted-to-drugs-and-what-did-they-do-in-that-time>

<https://www.thesun.co.uk/news/12772118/serial-killer-harold-shipman-murder-elderly/>

<https://www.thecriminalcode.com/index.php/2019/04/10/meet-the-modern-man-serial-killer-israel-keyes/>

<https://www.letelegramme.fr/ar/viewarticle1024.php?aaaammjj=19980303&article=19980303-3362822&type=ar>

<https://www.crimeandinvestigation.co.uk/shows/making-a-monster/articles/the-differences-between-male-and-female-serial-killers#:~:text=Male%20killers%20are%20nearly%20six,they're%20already%20familiar%20with.>

<https://casefilepodcast.com/case-108-the-kicevo-monster/>

<https://www.vqronline.org/dispatch/mask-sanity-trail-serial-killer-macedonia>

Compendium of Good Practices in the Rehabilitation and Reintegration of Violent Extremist Offenders (veocompendium.org)

<https://www.faz.net/aktuell/gesellschaft/massenmord-ein-phaenomen-der-moderne-1212948.html>

<https://www.thelocal.no/20160610/norway-is-the-least-peaceful-country-in-the-nordics/>